

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7813
E shtunë, 15 qershor 2024
Çmimi 0.50

Limaj kërkon nga anëtarësia të jenë të gatshëm për proceset e ardhshme politike | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



GJERMANIA RITHEKSON SE NORMALIZIMI MES KOSOVËS DHE SERBISË NËNKUPTON NJOHJE TË NDËRSJELLË | F. 3

PËRSHPEJTIMI I INTEGRIMIT EVROPIAN NË FOKUS TË SAMITIT TË PROCESIT TË BASHKËPUNIMIT NË EVROPËN JUGLINDORE | F. 5

DIALOGU KOSOVË-SERBI, AMBASADORI BAJRAMI: PA NJOHJE RECIPROKE S'MUND TË KETË NORMALIZIM | F. 5

EKONOMI



ISH-PUNONJËSIT E "RILINDJES" PROTESTOJNË PARA AKP-SË PËR 20 PËRQINDËSHIN, KËRKOJNË TË DREJTAT E TYRE | F. 8

FKEE FILLON SHOYRTIMIN E LISTËS SË PRITJES PËR SUBVENCIONIMIN E INVESTIMEVE NË SHITËPITË INDIVIDUALE | F. 8

SPORT



SHQIPËRIA SONTE DEBUTON NË 'EURO 2024' | F. 10

PANDELI MAJKO 'QYTETAR NDERI' I RAHOVECIT | FAQE 3

Komuna e Rahovecit i ka ndarë të premtën titullin "Qytetar Nderi" i Rahovecit ish-kryeministrit të Shqipërisë, Pandeli Majko. I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe Majko, i cili tha se është privilegj i madh për të, ta pranojë këtë dekoratë nga kryetari Smajl Latifi. Ky i fundit tha se duke qenë faktor unifikues në një periudhë të trazuar, Pandeli Majko dha kontribut real për të bashkuar faktorin shqiptar. E lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Majko ishte kryeministër i luftës që në momentet më vendimtare për Kosovën dha kontribut shumë të çmueshëm



INTERVISTË E MUHAMET MAVRAJ NË RTK ME GAZETARIN VALON BAJRAMI ME RASTIN E 25-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË KOSOVËS | FAQE 6-9

KY JUBILE I MADH I LIRISË, ÇEREKSHEKULLI, ËSHTË RAST I HUMBUR PËR FESTË TË MADHE



-Strategët e lirisë po përballën me gjepura në Hagë

- Pa frymën e rinisë studentore nuk do të kishte frymë të UÇK-së dhe, me çfarë jam thellë i bindur, pa UÇK-në nuk do të kishte intervenim të NATO-s, rrjedhimisht as çlirim të Kosovës

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Finlanda dyshon se katër avionë luftarakë rusë e shkelën hapësirën e saj ajrore

HELSINKI, 14 QERSHOR - Roja Kufitare e Finlandës ka thënë të premten se dyshon se katër avionë luftarakë të Rusisë e kishin shkelur hapësirën ajrore të vendit nordik më 10 qershor.

Të hënën e kaluar, Ministria e Mbrojtjes e Finlandës tha se dyshonte se avionë luftarakë

rusë e kishin shkelur hapësirën e saj ajrore për rreth dy minuta mëngjesin e së hënës. "Derisa hetimi po vazhdon, është bërë del që, përveç një avioni rus të raportuar më herët, ka po ashtu arsye për të dyshuar se edhe tre avionë të tjerë shkaktuan shkelje territoriale", tha të

premtën agjencia e rojës kufitare në një komunikatë.

Në komunikatën e saj thuhet se avionët rusë përbëheshin nga dy bombardues dhe dy avionë luftarakë.

Hera e fundit kur u konfirmua shkelja territoriale e Finlandës nga avionët luftarakë rusë ishte në gusht 2022, sipas Ministrisë.



Apeli në Shqipëri vendos më 25 qershor për ankesën e Belerit kundër dënimit me burg

TIRANË, 14 QERSHOR - Gjykata e Posaçme e Apelit në Shqipëri tha të premten se do të vendosë më 25 qershor për ankesën e Alfred Belerit, kryetarit të zgjedhur të bashkisë së Himarës, kundër dënimit me dy vjet burgim për vjedhje votash.

Në mars, Gjykata e Posaçme e dënoi Belerin me dy vjet burgim për akuzën e vjedhjes së votave në zgjedhjet lokale të 14 majit 2023. Ankesa e mbrojtjes së Belerit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë u shqyrtua të premten nga Gjykata e Apelit në Tiranë, e cila tha se vendimin do ta bëjë të ditur më 25 qershor.

Beleri dhe avokatët e tij mbrojtës i kanë cilësuar akuzat si politike dhe të pabazuara. "Provat ndaj meje janë manipuluar. Unë ndërgjegjen e kam të qetë dhe ju, kur ta shpallni vendimin, shpresoj ta keni ndërgjegjen e qetë", tha Beleri gjatë seancës.

Prokurori Adnan Xholi kërkoi që Apeli ta mbajë në fuqi dënimin e shkallës së parë kundër Belerit. Në seancën e së premtes morën pjesë familjarë dhe mbështetës



të Belerit, përfshirë edhe ambasadorin grek në Tiranë, Konstantina Kamitsi.

Beleri fitoi ulëse në Parlamentin Evropian si përfaqësues i partisë udhëheqëse në Greqi, Demokracia e Re, në zgjedhjet e qershorit.

Kreu i shoqatës së minoritetit

grek në Shqipëri "Omonia", Marin Suli, ka thënë për Radio Evropa e Lirë se Beleri ka deklaruar se, nëse shpallet i pafajshëm, ai "do ta zgjedhë mandatin e kryebashkiakut të Himarës" para ulëses së eurodeputetit.

Zgjedhja e Alfred Belerit si

deputet i Parlamentit Evropian shkaktoi polemika - si për legjitimitetin e tij, ashtu edhe për ndikimin e rastit të tij në integrimin evropian të Shqipërisë.

Juristë dhe ekspertë të marrëdhënieve ndërkombëtare thonë se rasti i tij ngre

shqetësime kushtetuese dhe ligjore.

Sipas tyre, ai mund të ndikojë edhe në përpjekjet e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, por edhe në marrëdhëniet e saj me Greqinë. Alfred Beleri, me shtetësi shqiptare dhe greke, ishte kandidat i opozitës për kryetar të Bashkisë së Himarës - qytet i banuar edhe me popullsi greke në jug të Shqipërisë - në zgjedhjet e majit të vitit 2023.

Ai u arrestua pak ditë para zgjedhjeve nën dyshimet për blerje votash.

Pavarësisht se ishte në paraburgim atëkohë, Beleri i fitoi zgjedhjet, por nuk u betua asnjëherë. Në mars të këtij viti u dënua me dy vjet burgim.

Rasti nxiti kritika të mëdha në Athinë, ku Ministria e Jashtme tha se "dënimi dyvjeçar është padyshim joproporcional me masën e veprës së supozuar".

Partia e kryeministrit grek, Kyriakos Mitsotakis, e emëroi pastaj kandidat për zgjedhjet për Parlamentin Evropian, të cilat u mbajtën nga data 6 deri më 9 qershor, ku ai u zgjodh.

Italia arreston personin që dyshohet se ndihmoi arratisjen e rusit të kërkuar nga ShBA-ja

ROMA, 14 QERSHOR - Italia arrestoi të premten një të dyshuar i cili akuzohet se e ndihmoi djalin e një guvernatori rus të ikte në vendin e tij derisa përballej me ekstradimin e Shteteve të Bashkuara, nën dyshimet për eksport të paligjshëm të teknologjisë ushtarake, njoftuan autoritetet.

Personi i arrestuar dyshohet se organizoi largimin e Artyom Uss nga Italia në mars të vitit 2023, një ditë pasi një gjykatë italiane miratoi ekstradimin e tij në Shtetet e Bashkuara.

Uss ishte një nga pesë rusët e arrestuar me kërkesë të Uashingtonit për "skema të paligjshme për të eksportuar teknologji të fuqishme ushtarake" amerikane në Rusi.

Uss u zhduk nga rezidenca e tij



dhe disa ditë më vonë njoftoi se ishte kthyer në Rusi.

I dyshuari i arrestuar të premten, gjithashtu rus, dyshohet se ka

ndjekur vendimet e gjykatës së Milanos që urdhëroi ekstradimin

e Uss dhe përgatitjen e një plani për arratisjen e tij.

Personi i dyshuar, një banor zviceran, akuzohet gjithashtu për "kontakt me anëtarët e bandës që më pas kryen arratisjen", thuhet në një deklaratë nga zyra e prokurorit publik të Milanos.

Prokuroria tha se 54-vjeçari, emrin e të cilit nuk e kanë bërë të ditur, ishte në kontakt të vazhdueshëm me familjen e Uss. Mediat italiane e identifikuan të dyshuarin si sipërmarrësin Dmitry Chirakadze, bashkëthemelues i grupit Pravo.ru, i cili ofron ndihmë për faqet e internetit të gjykatave ruse.

Gjithashtu u tha se ai është aksionar në "kompani të shumta ruse me përfshirjen e anëtarëve të familjes Uss".

Gjermania rithekson se normalizimi mes Kosovës dhe Serbisë nënkupton njohje të ndërsjellë

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, e ritheksoi qëndrimin e Gjermanisë se normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë duhet të përmbyllet me njohje të ndërsjellë. "Sa për ta rikujtuar: Lexojeni deklaratën e qartë të kancelarit Olaf Scholz gjatë vizitës së tij në Kosovë dhe në Serbi në qershor 2022, për normalizimin, përfshirë njohjen dypalëshe", shkroi Rohde në rrjetin social X të enjten vonë.

Ai tha se "kjo vlen ende", duke shtuar se rruga është tashmë e hapur për Kosovën dhe Serbinë përmes zbatimit "të menjëhershëm" të marrëveshjeve të arritura më 2023 për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore.

Deklarata e tij erdhi pak pasi ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, në një intervistë për edicionin e 13 qershorit të së përjavshmes NIN nga Beogradi, tha se njohja formale e Kosovës nuk do të jetë kusht për hyrjen e Serbisë në Bashkimin Evropian (BE).

Të enjten më herët, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, tha për Radion Evropë e Lirë se Serbia nuk mund të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian pa normalizimin e raporteve të saj me Kosovën. "Marrëveshja e Ohrit aktualisht e bën këtë shumë të qartë: Nëse nuk ka progres në normalizim, nuk do



të ketë progres në negociatat e anëtarësimit", tha ai.

Nën ndërmjetësimin e BE-së, Kosova dhe Serbia më 2023

arritën Marrëveshjen drejt normalizimit të marrëdhënieve. Më vonë ajo u bë e njohur si Marrëveshja e Ohrit, por edhe kjo

ka mbetur kryesisht e pazbatuar. Bashkimi Evropian, megjithatë, nuk është shprehur qartë nëse njohja formale e Kosovës do të jetë

kusht për Serbinë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, dhe Stano përsëriti se "qëndrimi i bllokut rreth kësaj çështjeje mbetet i pandryshuar".

Prej se Kosova e shpalli pavarësinë, 15 vjet më parë, Bashkimi Evropian është shprehur vazhdimisht se çështja e njohjes së Kosovës është një çështje në kompetencë të vendeve anëtare të BE-së dhe, si bllok evropian, ka mbajtur një qëndrim neutral ndaj statusit të Kosovës.

Por, në anën tjetër, Kosova ka raporte të veçanta kontraktuale me Bashkimin Evropian, përmes Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, ndërsa në procesin e negociatave të anëtarësimit të Serbisë në BE nuk përfshihet territori i Kosovës.

Në BE gjithmonë kanë ngulur këmbë që të përdorin normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Kosovën si kusht për Serbinë. Interpretimin se a nënkupton "normalizimi i plotë" edhe njohjen formale të Kosovës nga Serbia, në BE ua kanë lënë palëve ta interpretojnë vetë.

Një zyrtar i BE-së, duke rikujtuar edhe ndryshimet në kornizën e negociatave të anëtarësimit të Serbisë në BE, ku në kapitullin 35 është përfshirë si kusht edhe normalizimi i raporteve me Kosovën, ka thënë se pa këtë normalizim, Serbia nuk mund të bëhet anëtare e BE-së.

Vuçiq bisedon me Sarrazinin për 'marrëveshjet e pazbatuara' mes Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha të premten se ka biseduar me të dërguarin e posaçëm të Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, për dialogun ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, si dhe për situatën në rajon.

Vuçiq shkroi në llogarinë e tij në Instagram se ka pasur një bisedë "të hapur dhe të drejtpërdrejtë" me Sarrazin për "marrëveshjet e pazbatuar" nga dialogu mes Beogradit dhe Prishtinës, "në radhë të parë, ato që kanë të bëjnë me sigurinë e serbëve në Kosovë, posaçërisht themelimin e Asociacionit me shumicë serbe". "Përsërita se Gjermania dhe komuniteti ndërkombëtar në Serbi kanë një partner të besueshëm në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit, forcimin e bashkëpunimit dhe prosperitetit rajonal. Por, mbrojtja e interesave kombëtare të shtetit dhe popullit serb do të jetë gjithmonë prioriteti ynë", tha Vuçiq.

Një ditë më herët, ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn



Rohde, e ritheksoi qëndrimin e Gjermanisë se normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë duhet të përmbyllet me njohje të ndërsjellë.

Nën ndërmjetësimin e BE-së, Kosova dhe Serbia më 2023 arritën Marrëveshjen drejt

normalizimit të marrëdhënieve. Më vonë ajo u bë e njohur si Marrëveshja e Ohrit, por edhe kjo ka mbetur kryesisht e pazbatuar. "Sa për ta rikujtuar: Lexojeni deklaratën e qartë të kancelarit Olaf Scholz gjatë vizitës së tij në Kosovë dhe në Serbi në qershor

2022, për normalizimin, përfshirë njohjen dypalëshe", shkroi Rohde në rrjetin social X të enjten vonë.

Ai tha se "kjo vlen ende", duke shtuar se rruga është tashmë e hapur për Kosovën dhe Serbinë përmes zbatimit "të menjë-

hershëm" të marrëveshjeve të arritura më 2023 për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore.

Deklarata e tij erdhi pak pasi ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, në një intervistë për edicionin e 13 qershorit të së përjavshmes NIN nga Beogradi, tha se njohja formale e Kosovës nuk do të jetë kusht për hyrjen e Serbisë në Bashkimin Evropian (BE).

Të enjten më herët, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, tha për Radion Evropë e Lirë se Serbia nuk mund të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian pa normalizimin e raporteve të saj me Kosovën.

Ato arritën marrëveshje edhe për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën. Serbia kërkon që Kosova të zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik.



Përsheptimi i integritit evropian në fokus të Samitit të Procesit të bashkëpunimit në Evropën Juglindore

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Mesazhet për përsheptimin e integritit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian (BE), ruajtja e paqes dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, thellimi i bashkëpunimit rajonal dhe afrimi me tregun e përbashkët evropian, ishin në fokus të samitit të krerëve të shteteve dhe të qeverive të Procesit për Bashkëpunim në Evropën Juglindore (SEECP). Samiti u mbajt të enjten në Shkup të Maqedonisë së Veriut ku pjesëmarrësit vlerësuan punën e deritanishme të këtij forumi, para se gjithash në "mbylljen e çështjeve të hapura, ndërtimin e besimit të ndërsjellë dhe atë të bashkëpunimit për arritjen e qëllimit të përbashkët- flamurin e Bashkimit Evropian".

Në këtë samit rajonal, morën pjesë presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj dhe ai i Malit të Zi, Jakov Milatoviç.

Presidenti malazez mori pjesë në cilësinë e ish-shtetit kryesues me Procesin e Bashkëpunimit në Evropën Juglindore ndërsa presidenti shqiptar në cilësinë e kryesuesit e ardhshëm me këtë

forum rajonal. "Ne kemi një përgjegjësi të përbashkët për të kontribuar në ruajtjen e paqes në Evropë, ndërtimin e një kontinenti demokratik, të sigurt dhe të begatë", tha presidentja maqedonase, Gordana Siljanovska Davkova.

Përsheptimi i integritit evropian dhe avancimi i bashkëpunimit rajonal janë me rëndësi në bashkëpunimin e mëtejshëm të shteteve, theksoi presidenti malazez, Jakov Milatoviç. "Është e rëndësishme që ne të qëndrojmë me vendosmëri në rrugën e zhvillimit demokratik dhe sundimit të ligjit, sepse vetëm kështu shoqëritë tona mund të avancojnë në mundësinë e ofruar nga entuziazmi i zgjuar dhe momenti i ri që kemi në Bruksel për zgjerimin e unionit", tha Milatoviç.

Presidenti shqiptar, Bajram Begaj tha se Shqipëria si kryetare e ardhshme do të mbetet proaktive në mbështetjen e bashkëpunimit rajonal. "Shqipëria do të fokusohet në një sërë prioritetesh për anëtarësimin në BE, stabilitetin ekonomik, agjendën e gjelbër dhe digjitale, turizmin, kulturën", tha Begaj.

Ndër zyrtarët më të lartë shtetërorë në Shkup ishte presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu si dhe kryetari i Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, Denis Beqiroviç.

Shtetet tjera u përfaqësuan në nivele të përfaqësuesve të ministrive të jashtme dhe të ambasadorëve. Në mesin e tyre ishte edhe shefi i diplomacisë greke, Jorgos Gerapetritis, që shënon edhe takimin e parë të një zyrtari të lartë grek me presidenten e re maqedonase, Gordana Siljanovska Davkova, e cila refuzon të përdor emrin e shtetit Maqedonia e Veriut, gjë që ka shkaktuar reagime të shumta në Athinë.

Në Samit morën pjesë edhe përfaqësues nga Bashkimi Evropian; zëvendës drejtori në Shërbimin Evropian për Punë të Jashtme të BE-së, Marko Makovec dhe përfaqësuesja e Komisionit Evropian, Ana Veziroglu.

Paraprakisht, është mbajtur takimi i përfaqësuesve të Ministrive të Punëve të Jashtme në të cilin është biseduar për "marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, stabilitetin,

sigurinë dhe bashkëpunimin në Evropën Juglindore" dhe "aspiratat për integrimin në strukturat euroatlantike".

Bujar Osmani në cilësinë e kryesuesit të Procesit për Bashkëpunim në Evropën Juglindore (SEECP) dhe ministër i aktual i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut është takuar me zëvendësministren e jashtme të Greqisë, Aleksandra Papadopulo më të cilën kanë biseduar kryesisht për integrimin evropian dhe detyrimin për zbatimin e Marrëveshjes së Prespës. "Kemi biseduar për përkushtimin e dy shteteve jo vetëm për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, por edhe për mbështetjen që Athina i jep vendit tonë në procesin e integritit evropian. Marrëveshja e Prespës është më shumë se sa një marrëveshje për çështjen e emrit. Ajo është shtylla e integritit evropian dhe e forcimit të fqinjësisë mes dy vendeve", ka thënë Osmani.

Një ditë para takimit ministror dhe Samitit të krerëve të shteteve dhe qeverive, në Shkup u mbajt takimi vjetor i Këshillit për Bashkëpunim

Rajonal (RCC), i cili është organ ekzekutiv i Procesit për Bashkëpunim në Evropën Juglindore (SEECP).

Shefi i diplomacisë, Bujar Osmani e cilësoi përfundimin e presidencës njëvjeçare të këtij procesi si fitore të diplomacisë së Maqedonisë së Veriut sepse të mërkurën në Shkup u arrit marrëveshje për sekretarin e ardhshëm të përgjithshëm të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Funksinin do ta ushtronte Amer Kapetanoviç nga Bosnja dhe Hercegovina.

Procesi i Bashkëpunimit në Evropën Juglindore është një iniciativë për bashkëpunim rajonal, që është lansuar më 1996.

Ajo synon të forcojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë midis shteteve të Evropës Juglindore dhe ta transformojë këtë rajon në një fushë të paqes, sigurisë, stabilitetit dhe bashkëpunimit, me synimin kryesor të integritit të plotë në strukturat evropiane dhe euroatlantike.

Vendet anëtare të SEECP janë Kosova, Shqipëria, Turqia, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Mali i

Dialogu Kosovë-Serbi, ambasadori Bajrami: Pa njohje reciproke, s'mund të ketë normalizim

PRISHTINË, 14 QERSHOR - "Pa njohje reciproke, nuk mund të ketë normalizim", kështu ka thënë ambasadori i Kosovës në Bruksel, Agron Bajrami. Përmes një postimi në platformën "X", ai tutje është shprehur se qëllimi i dialogut të udhëhequr nga BE-ja është të arrihet normalizimi i plotë i

marrëdhënies mes Kosovës dhe Serbisë. "Është e thjeshtë: Qëllimi i Dialogut në Bruksel i udhëhequr nga BE-ja është të arrihet normalizimi i plotë i marrëdhënies ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pa njohje reciproke, s'mund të ketë normalizim", ka shkruar Bajrami.

Ky reagim i ambasadorit Bajrami vjen një ditë pas deklaratave të ambasadorit amerikan në Serbi, Christopher Hill, i cili dje tha se njohja formale e Kosovës nuk do të jetë kusht për hyrjen e Serbisë në BE, por normalizimi i marrëdhënies fqinjësore me të.



Pandeli Majko “Qytetar Nderi” i Rahovecit

Komuna e Rahovecit i ka ndarë të premtën titullin “Qytetar Nderi” i Rahovecit ish-kryeministrit të Shqipërisë, Pandeli Majko. I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe Majko, i cili ka tha se është privilegj i madh për të, ta pranojë këtë dekoratë nga kryetari Smajl Latifi. Ky i fundit tha se duke qenë faktor unifikues në një periudhë të trazuar, Pandeli Majko dha kontribut real për të bashkuar faktorin shqiptar. E lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Majko ishte kryeministër i luftës që në momentet më vendimtare për Kosovën dha kontribut shumë të çmueshëm

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

RAHOVEC, 14 QERSHOR - Rahoveci të premtën ka shënuar një ndër ditët më të gëzueshme në historinë më të re, Ditën e Çlirimit të komunës nga pushtuesit gjakatar serbë.

Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se populli i kësaj ane mbështeti fuqishëm dhe me të gjitha mjetet luftën e lavdishme të UÇK-së, mirëpo humbën shumë njerëz, gjaku i të cilëve forcon themelet e lirisë që po e gëzojmë sot. “Ishte fat historik për shqiptarët që në krye të qeverisë shqiptare të jetë një personalitet karizmatik dhe i guximshëm, i cili nuk ngurroi t’i kundërvihet çdo tendence për ndalimin e mbështetjes ushtarake të NATO-s për Kosovën. Duke qenë në krye

të qeverisë shqiptare, Pandeli Majko mblodhi krerët e partive politike pas Masakrës së Reçakut dhe u kumtoi atyre: Kur serbët na vrasin, ne duhet të bashkohemi! Duke qenë faktor unifikues në një periudhë të trazuar, Pandeli Majko dha kontribut real për të bashkuar faktorin shqiptar, duke shmangur edhe situata konflikti ndërshqiptar, që mund t’i kishin kushtuar rëndë kauzës së çlirimit të Kosovës. Njohësit e rrethanave politike të asaj kohe e kanë cilësuar si ‘të vetmin politikan normal’. Ai me vendosmëri kërkoi nga faktori ndërkombëtar dhe konkretisht nga NATO, që të ndërmarrë të gjitha masat për parandalimin e gjenocidit dhe të spastrimit etnik të Kosovës. Pas dëbimit masiv të shqiptarëve nga trojet e lashta stërgjyshore, kriza humanitare e Kosovës mori një

kthesë vendimtare pozitive, pas deklaratës së Pandeli Majkos, se Shqipëria mund të presë çdo të dëbuar nga Kosova”, ka thënë Latifi, duke theksuar se ka edhe një fakt, që përbën anën e shkëlqyer të shtetit shqiptar dhe të qeverisë së asaj kohe. “Kryeministri Pandeli Majko dhe të gjithë ministrat e tij kanë nënshkruar një dokument sekret në qeveri, ku ushtria shqiptare merrte përsipër zyrtarisht furnizimin e UÇK-së me armë. Në këtë mënyrë, Kosova mbetet çështje e zemrës për atdhetarin

Pandeli Majko. Vëllai ynë, Pandeli Majko, e ka bërë të tijën kauzën e Kosovës. Ngado që vete dhe me këdo që takohet, ai e ka Kosovën në krye të agjendës së tij politike, duke potencuar se bashkimi i natyrshëm i shqiptarëve mund të bëhet, mirëpo duhet pasur parasysh një fakt (citoj): ‘Si mund të integrohemi te të tjerët kur nuk jemi të aftë ta bëjmë të ndodhë me njëri-tjetrin?!’. Janë përplot arsye që na kanë shtyrë që t’ia propozojmë Kuvendit të Komunës së Rahovecit, dhënien e titullit ‘Qytetar Nderi’ këtij personaliteti përmasash kombëtare. Falënderoj secilin anëtar të Kuvendit që e mbështetën këtë propozim dhe që mundësuan dekorimin e z. Pandeli Majko me këtë titull nderi”, ka thënë kryetari Latifi. Ai ka shtuar se ky dekorim nuk është vetëm për ish-kryeministrin Pandeli Majko, por për të gjithë ata që e mbështetën në këtë kauzë dhe që kontribuan çlirimin e një pjese të trojeve shqiptare. “Duke e uruar zotin Pandeli Majko për qëndrimin e tij stoik dhe frymëzues, e përgëzoj për këtë dekoratë nderi!”, ka theksuar kryetari i Rahovecit, Smaj Latifi. Po ashtu, shefat e grupeve parlamentare patën mundësinë për nga një fjalë rasti. Në fund, ish-kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Pandeli

Majko, falënderoi kryetarin e komunës për këtë nder. “Është privilegj i madh të pranoj këtë dekoratë nga kryetari z. Smajl Latifi ‘Qytetar Nderi i Rahovecit’ dhe përtej modestisë nuk e di a i kam merituar gjithë ato çka u thanë për mua, kur unë nuk kam bërë asgjë më shumë se çka është dashur të bëja si kryeministër në atë kohë të vështirë lufte”, u shpreh Pandeli Majko. Në këtë ceremoni ka marrë pjesë edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se Majko ishte kryeministër i luftës që në momentet më vendimtare për Kosovën dha kontribut shumë të çmueshëm. “Qershori sjell kujtimet e vitit 1999, kur qytetet tona çliroheshin njëra pas tjetres dhe po realizohej aspirata jonë shekullore për të qenë të lirë në tokën dhe të drejtën tonë. Qytetarët e Rahovecit, njerëz punëtorë e të urtë, asnjëherë nuk iu nënshtruan okupimit, por u bënë prijës të shumë organizimeve për liri, rrugë e cila nuk ishte aspak e lehtë. Në ditën që shënon çlirimin e Rahovecit, Komuna nderoi me çmimin ‘Qytetar Nderi’, ish-kryeministrin e Shqipërisë Pandeli Majko. Ai ishte kryeministër i luftës që në momentet më vendimtare për Kosovën dha kontribut shumë të çmueshëm. E falënderova për shërbimin e tij ndaj Atdheut!”, ka thënë Haradinaj.



Komisioni Hetimor, më 21 qershor propozon tre ekspertë për procesin e subvencionimit të blerjes së teksteve shkollore

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Komisioni Hetimor Parlamentar për procesin e subvencionimit të blerjes së teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore për nxënësit e nivelit të arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të ulët për vitin shkollor 2023/2024, të premtën ka diskutuar rreth angazhimit të ekspertëve. Deputeti nga radhët e

Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Shemsedin Dreshaj, tha se janë nëntë aplikimet. Deputeti nga Partia Demokratike e Kosovës, Bekim Haxhiu, tha se në bazë të nevojave i sheh tre ekspertë, në fushën e ekonomisë, një ekspert në auditim dhe një ekspert në financa dhe pastaj gjithsecili të ofrojë një ekspertizë me eksperiencën e tij profesionale.

Ndërsa, deputeti nga pushteti, Armend Muja, tha se versioni ishte i shkurtër, duhet për të vlerësuar se kush i ka plotësuar kushtet. Derisa, deputetja e LDK-së, Vlora Dumoshi, ka thënë se dokumentacioni është i kompletuar. Komisioni vendosi që të premtën të mbahet mbledhja e radhës për të propozuar emrat e tre ekspertëve.



INTERVISTË E MUHAMET MAVRAJ NË RTK ME GAZETARIN VALON BAJRAMI
ME RASTIN E 25-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË KOSOVËS

Ky jubile i madh i lirisë, çerekshekulli, është rast i humbur për festë të madhe

- Strategët e lirisë po përballën me gjepura në Hagë
- Pa frymën e rinisë studentore nuk do të kishte frymë të UÇK-së dhe, me çfarë jam thellë i bindur, pa UÇK-në nuk do të kishte intervenim të NATO-s, rrjedhimisht as çlirim të Kosovës



LAJMET
E FUNDIT

KOSOVA 25 VJET PAS LUFTËS

Prof. Muhamet Mavraj, analist

PRISHTINË, 12 QERSHOR 2024

RTK: Me ne sonte në studio për të diskutuar për 25-vjetorin e çlirimit dhe zhvillimet tjera politike në vend na është bashkëngjitur profesori dhe analisti Muhamet Mavraj. Profesor, mirë se erdhët, faleminderit shumë për kohën!

MAVRAJ: Respekt! Faleminderit për ftesën!

RTK: Atëherë, meqë kjo është java kur po shënohet 25-vjetori i çlirimit dhe përfundimit të intervenimit të forcave të NATO-së, pashmangshëm edhe këtë bisedë po e nisim me këtë datë dhe rëndësinë historike të saj. Po kthehemi në retrospektivë, para fillimit të luftës, tek protestat e 1 tetorit të vitit 1997, sepse faktikisht nis me studentë për t'i thënë stop gjenocidit të regjimit të Millosheviqit... Prof., na kujtoni pak nga ato momente, na sillni diçka më interesante nga ajo kohë, po më intereson – ndoshta është kureshtja

edhe e shikuesve, se a keni qenë në atë kohë si studentë dhe Union me strukturat e UÇK-së për këto protesta?

MAVRAJ: Faleminderit, Valon! Nëse më lejoni do të ua uroja këtë jubile të madh të gjithë shqiptarëve, mbarë kombit shqiptar, familjeve të dëshmorëve, të gjithë luftëtarëve të lirisë dhe një përhëndetje – urim special strategëve të lirisë të cilët mbahen ende, edhe për një kohë, padrejtësisht në Hagë. 1 tetori i vitit 1997 nuk është nisur si nismë për ndaljen e gjenocidit, sepse atëherë ende nuk ishte ushtruar gjenocid, por është datë që i jep fund njëherë e përgjithmonë politikës së ndejtjes ose lëvizjes së ndejtjes ose politikës pacifiste (që ishte) pa aksion. Nëpërmjet kësaj (prej 1 tetorit 1997) gradualisht është krijuar fryma e cila i krijon terren të përshtatshëm frymës çlirimtare. Me fjalë të tjera, nuk dua ta kushtëzoj në mënyrë kategorike ashtu, por në njëfarë mënyre, pa frymën e rinisë studentore nuk do të kishte frymë të

UÇK-së dhe, me çfarë jam thellë i bindur, pa UÇK-në nuk do të kishte intervenim të NATO-s, rrjedhimisht as çlirim të Kosovës. Sot është ditë kur duhet t'i nderojmë të gjithë studentët dëshmorë, meqenëse po e nis bisedën nga aty, të gjithë studentëve luftëtarë ju shpreh mirënjohje të thellë, të gjitha familjeve të tyre. Sot është 25-vjetori, një jubile i madh, në fakt jubileu i parë i madh i çlirimit të Kosovës dhe si i tillë ka merituar të jetë një jubile shumë më festiv, më i fuqishëm me miqtë e Kosovës këtu në Kosovë, me miqtë që na kanë ndihmuar në atë kohë të çlirohemi, por edhe me përfaqësuesit e (sotëm zyrtar të) shteteve të tyre, përfshirë kryetarin amerikan, z. Bidenin, i cili sot e ka pasur ditën të jetë këtu në Kosovë dhe do të vinte në rrethana të tjera me shumë dëshirë, sepse është njëri nga protagonistët e gjallë që ka bërë shumë, shumë, shumë për çlirimin e Kosovës. Më herët edhe për Bosnjën, por për Kosovën dhe kombin shqiptar ka bërë shumë.

Mirëpo, jemi siç jemi, jemi ku jemi në këto rrethana çfarë i kemi. Disa nga ish-zyrtarët e asaj kohe na uruan edhe nëpërmjet video-lidhjeve ose video-mesazheve, pra nga distanca. Ndonjëri simbolikisht ishte këtu, por jo siç do të mund ta kishim këtë jubile të parë të madh, sepse është çerekshekulli, Valon, është shumë i rëndësishëm. Vetë Aleanca e NATO-s do të kishte për të dhënë ndonjë mesazh sidomos tani në kontekstin e zhvillimeve dhe kërcënimeve për ndarjen e Bosnje-Hercegovinës, por edhe për aktivitetet gjithnjë e më të fuqishme të rusëve në Kosovë, Serbi, Maqedoni, Mal të Zi, Bosnjë, në vetë Serbinë e kështu me radhë. Me vjen shumë keq që ishte ditë ose rast i humbur për Kosovën.

RTK: Po mendoni që ka qenë i zbehtë ky shënim i kësaj date sot?

MAVRAJ: Nëse e marrim si jubile, si çerekshekull, po, shumë i zbehtë. E di që në rrethana të tjera, me liderë të tjerë do të ishte krejtësisht më ndryshe. Do të ishte vërtet festë edhe

në fytyrat e shqiptarëve të Kosovës, edhe në zemrat e tyre më shumë festë, por edhe Kosova do të dilte shumë më e fortë nga kjo ditë e sotme. Shohim tutje në jubiletë e ardhshëm...

Universitetin e vendosëm 100 % në krah të UÇK-së

RTK: Gjatë këtij historiku që e thate për shikuesit tanë përmendet se shumë kolegë tuaj si studentë në vitin '97 i janë bashkëngjitur UÇK-së dhe disa ishin pjesë e UÇK-së. Kjo ishte dëshmia më e madhe tek faktori ndërkombëtar për të pasqyruar, po e them, terrorin, sepse ishte...

MAVRAJ: Ka pasur shumë rëndësi që bota ta sheh Universitetin e Prishtinës dhe rininë studentore 100 për qind në krah të UÇK-së. Çfarëdo drejtimi tjetër do ta zbehte përkrahjen për UÇK-në, e kam fjalën kryesisht për përkrahjen ndërkombëtare. Dhe përkrahja që erdhi nga koha jonë ka qenë që prej

gazetës studentore deri të rektorati, bile nëse nuk gaboj, Kuvendi i Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës (ku isha kryetar), është i vetmi institucion shtetëror që ka bërë deklaratë zyrtare në përkrahje me vendim zyrtar në Kuvendin e përgjithshëm të tij për UÇK-në. Është 15 janari i vitit 1999. Si dokument zyrtar më sa di unë nuk ekziston një tjetër. Tash ky universiteti ynë (i Prishtinës) nuk po përkujdeset shumë për trashëgiminë e vet, as për 1 Tetorin as për këtë deklaratë që është historike, as për shumë gjëra të tjera, sepse do të dilte më kuptimplotë roli i Universitetit të Prishtinës në atë kohë. Ka pasur tendencë që të jetë e kundërta e asaj që ishte (ky Universitet), por falë punës, përkushtimit, pjekurisë kemi arritur që Universitetin e Prishtinës, thjesht, bota ta shoh si shtëpi të dytë të UÇK-së gjë që ka pasur rëndësi shumë të madhe atëherë. Personalisht vend/rast kudo që ka qenë e mundshme nuk e kam lëshuar pa e bërë të qartë, haptas e fuqishëm përkrahjen për UÇK-në. Prandaj, ka qenë shumë e natyrshme që studentët të ngarendin dhe t'i mbushin radhët e UÇK-së me aq sa ata kanë mundur, varësisht ku kush ka qenë, në zonën e vet ose në zonat tjera e kështu me radhë. Jam shumë krenar për atë periudhë.

Kosova është rrëfim suksesi dhe jo rrënim siç thotë propaganda ruso-serbe

RTK: Prof., tani ku jemi si shtet pas 25 vitesh pas përfundimit të luftës? Sa jeni të kënaqur personalisht me këto arritje sepse siç thamë, studentët, Unioni i asaj kohe ishin pjesë e themelit, çlirimit dhe

ndërtimit të shtetit?

MAVRAJ: Si shtet, si shoqëri Kosova ka ecur shpejt që në vitet e para të pasluftës. Fatkeqësisht 10-vjetëshi i fundit është periudhë e rënies. Unë shpesh e them se ata që kanë vdekur në ditët e para të çlirimit po të ngritën nga varri nuk dinë t'i gjejnë shtëpitë e tyre nga zhvillimi i madh që është bërë në ambientet shqiptare. Ata që kanë vdekur para lufte nuk dinë ta gjejnë fshatin e tyre, sepse ka ndryshuar pamja, ka ndryshuar fytyra e tij, -zhvillim i madh. Të merr malli me pa baltë. S'kanë baltë më fshatrat tona. Tani se ku jemi është diçka tjetër dhe ku kemi mundur të ishim është krejtësisht diçka tjetër, por e thotë e gjithë bota se Kosova më të vërtetë është storie suksesi, që i bie se mund të merret model për kombet tjera që mund ta kenë fatin sikurse tonin që e kishim. Është një brengë e madhe që zhvillimi i madh i vetë Kosovës nga vetë njerëzit e Kosovës të shihet nëpërmjet propagandës ruse dhe serbe si shkatërrim i Kosovës. Nuk është shkatërruar Kosova, është shkatërruar Serbia në Kosovë, faktikisht. Prandaj, kemi shumë arsye që të ndihemi shumë krenarë edhe për nivelin e demokracisë tonë, edhe për nivelin e pjekurisë politike, edhe të institucioneve tona, edhe për zgjedhje të lira dhe demokratike, edhe për kulturë shtetërore deri diku, por kemi një rënie në këto vitet e fundit që shpresoj se është vetëm si test, si provë ose periudhë kalimtare. Pa asnjë dyshim jam shumë optimist që Kosova do të kthehet në binarët e vet dhe ta ndjek atë drejtim që e kishte që në krye të herës, e ajo është gjithmonë, bindshëm: drejtimi perëndimor, në radhë të parë, integrimi në NATO dhe ku të mundemi tutje të arrijmë.

Perëndimi gaboi me Gjykatën Speciale

RTK: Profesor, ky jubile, pra 25-vjetori i çlirimit, siç theksuat edhe ju, ish-liderët e UÇK-së i gjen në Dhomat e Specializuara në Hagë. Çfarë do të thotë kjo për vetë UÇK-në dhe shtetin e Kosovës?

MAVRAJ: Do të thotë goditje siç ka qenë në fillim. Perëndimi gaboi që ra në grackën ruso-serbe në atë kohë. Këshilli i Evropës gaboi që e fuqizoi raportin e Dick Martyt dhe që i kërkoi Kosovës që ta bëjë atë që e bëri dhe për fat të keq për shkak të mosgjindshmërisë tonë, mospjekurisë sonë në momente të caktuara, gjithë ky çmim i madh, gjithë ky ndëshkim i madh, gjithë ky nam i madh, që Kosova të ia krijojë vetes një Gjykatë Speciale, në fakt, Kosovës i shkoi pas asnjë të vetmin shpërbllim. Do të duhej të pranohej në Këshillin e Evropës qysh me themelimin e saj. Tani ne po e shohim se edhe evropianët kanë një sy tjetër sa i përket kësaj gjykate sepse është produkt rus dhe ma merr mendja se po të ishte pas fillimit të luftës ruse në Ukrainë ajo gjykatë kurrë nuk do të formohej, s'do ta kërkonte kush. Sot, në fund të fundit, Rusia s'është fare anëtare, është e dëbuar nga Këshilli i Evropës. Mua me vjen keq që ata po përballen me turli lloj dëshmitari nga më të ulët të mundshëm që i kam parë, me vjen shumë keq ta them, për disa vonë tani që i pamë. Si strateg të lirisë, si kampionë të lirisë përballen me gjeputa të tilla, aq të ulëta me të cilat as nuk kanë lidhje fare hiç, as që dinë që ka ndodhur ndonjëherë diçka e tillë. Por, edhe kjo një ditë do të përfundojë dhe ma merr mendja se nëse edhe politika e bën te veten siç e ka bërë për

formimin e saj, ata duhet të kthehen në Kosovë ndoshta pa përfunduar gjyqi tërësisht. Për aq sa kam parë, sepse atje shumica e gjërave janë të mbyllura, për aq sa kam parë haptas (nga seancat publike) është turp për Evropën që ta lejojë një gjykatë të tillë. Për aq sa kemi parë deri më tani nuk ka prova për të akuzuar eprorë aq të lartë të lirisë së një kombi. Çfarë do të bëjnë sot me Ukrainën, çfarë do të bëjnë sot me rastet tjera? 120 konflikte të armatosura janë sot në botë. 120, të vogla, të mëdha, të brendshme ose ndërshtetërore sikurse është rasti Rusi-Ukrainë e kështu me radhë. Kosova nuk e meritonte këtë dhe Kosova nuk ishte shtet agresor i askujt. Kosova, thjesht ka zhvilluar rezistencën e vet, luftën e vet për çlirimin e vetes bashkë me ata që e kanë themeluar këtë gjykatë.

Kërkimi i spiujve duhet të bëhet që nga kokat e institucioneve

RTK: Profesor, a mund të themi në aspektin e përgjithshëm se jemi fajtorë edhe ne si komb, tash duke e marrë parasysh, pa dashur të gjykojmë hipotetikisht edhe rastin e fundit të të dy të arrestuarve që pretendohet se janë bashkëpunëtorë të BIA-s serbe dhe ndoshta në këto edhe dikush tjetër mund të këtë ndërlidhje me këtë proces të Hagës?

MAVRAJ: Unë nuk e di nivelin e provave që e kanë organet tona shtetërore për këta, por cilido që të jetë niveli këto dy raste janë raste të peshqve të vegjël. Kërkimi i tyre duhet të fillojë nga kokat e institucioneve shtetërore e poshtë, por edhe kështu nga poshtë-lartë nuk është keq. Nuk do të doja t'i ngarkoja, njëri nga ta është baba i një

kolegu gazetar (të një televizionit), nuk do të doja t'i rëndojmë as ata ende pa thënë gjë drejtësia, por jam thellë i bindur që kashumë spiuj dhe disa pa vetëdije i shërbejnë strategjive të tyre dhe qëllimin kryesor e kanë, thjesht, denigrimin e shqiptarëve dhe shfajësimin sa më të madh të ushtrisë serbe, policisë serbe dhe në përgjithësi shtetit serb. Ky është gabim i madh. Kështu nuk mund të vazhdohet dhe institucionet tona duhet të jenë më aktive në këtë drejtim dhe t'ua ndalin hovin, sepse me të vërtetë kanë çuar shumë kry. Janë të inspiruar nga rusët, janë të inspiruar nga serbët. Ka hyrë pare e madhe, ka hyrë propagandë e madhe, por ne, në fund të fundit, jemi këtu dhe do të dimë të reagojmë nëse eventualisht e shohim se po teprohet në këtë drejtim.

Me raporte të këqija me të gjithë, ku po shkojmë kështu?

RTK: Profesor, megjithatë, pavarësisht kësaj beteje, sakrificës së popullit tonë, përpjekjeve për avancimin e proceseve të shtetit tonë, ne ende kemi një polarizim të subjekteve politike, madje edhe kur bëhet fjalë për çështje madhore. Po më intereson se pse ky diskurs, pse këto mosmarrëveshje, kjo mungesë e koordinimit, dakordimit, në mes të politikës në përgjithësi në Kosovë?

MAVRAJ: Shiko, kjo është çështje e pluralizmit politik. Ne kemi luftuar që të kemi pluralizëm politik. Ne e kemi zgjedhur këtë model dhe është normale që të ketë mospajtime, por nuk është normale që Kosova të priset me Shqipërinë; Nuk është normale që Kosova të ketë marrëdhënie të ftohta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA); Nuk



është normale që sot të vijmë në një situatë ku Shqipëria të kërkojë grup uniteti. Ne nuk kemi më nevojë për grup të uniteti, kemi shtet, kemi institucione shtetërore, nuk jemi klub i fiseve, por ja që kjo ndodhi (të shihet si nevojë). Duke i parë të gjitha këto polarizime, mendoj se jemi në situatë kur do të duhet polemikat të zhvillohen vetëm për sa i përket orientimit strategjik të Kosovës, aty të kapemi. Dhe atë që po e kërkojnë si grup uniteti, thjesht ta kemi një konsultim të gjallë, online, 24 orë online me Shqipërinë dhe ShBA-në. Grindjet e vogla që ndodhin janë shumë normale edhe në Kosovë, edhe në Shqipëri dhe në vendet tjera, sepse ne vetë jemi përcaktuar për pluralizëm politik, por jo grindje deri në përmasën e izolimit total të Kosovës, hap pas hapi. Keq me shqiptarët e Luginës, keq me shqiptarët në Maqedoni, keq me Qeverinë e Shqipërisë, ftohtë me ShBA-në... Ku do shkojmë kështu ne? Ne kishim një perspektivë shumë të qartë të mëparme. Orientimi pro Amerikës është historik, tradicional, është jetik dhe aty ka vend për kritikë. Aty ka vend për fushatë në të ardhmen dhe gjithësesi duhet t'i përmirësojmë ose ky shtet do të dështojë.

Qeveria po punon për strategjinë ruso-serbe

RTK: Një çështje tjetër që lidhet pikërisht me këto, çështjen e masave, tërheqjes së vërejtjes së faktorit ndërkombëtar janë edhe disa pika që konsiderohen ose që duhen... obligime ligjore që duhet të plotësohen nga Kosova e Serbia dhe po shohim kohëve të fundit, prof., që është shtuar presioni i faktorit ndërkombëtar sa i përket themelimit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe. Pamë që kryeministri Kurti ka kërkuar që draft-statuti të dërgohet në Komisionin e Venecias, kurse BE-ja thotë se përfshirja e Komisionit të Venecias nuk është e paraparë në marrëveshjen e dialogut që lidhet pikërisht me themelimin e Asociacionit.

MAVRAJ: Unë nuk po e përmend kot strategjinë ruse të zvarritjes së çështjes së Kosovës. Ne jemi thellë-thellë brenda asaj strategjie, për fat të keq. Me vjen shumë keq që po e them në televizion publik dhe po më vjen keq për njerëzit që deri dje i kam pasur shokë. Çështja e Venecias si inovacion, si shpikje shkon në kuadër të këtyre zvarritjeve të problemit të Kosovës dhe zvarritjes së integritetit të Kosovës, atje ku synon të integrohet. Kosova është nën sanksione të Bashkimit Evropian (BE) dhe miqve të Kosovës, prandaj s'i ke sot në 25-vjetor këtu, askënd hiç fare, sepse ndonëse na kanë ndihmuar të çlirohemi sot jemi nën sanksione të tyre. Dhe, faji fare s'është i tyre, dhe e dimë mirë se faji është i yni, dhe jam kundër çdo lloj



diskursi që përpiqet ta zhvendos fajin tonë tek miqtë, sepse s'është e vërtetë, sepse faktet e thonë krejtësisht tjetër, sikurse e patëm rastin tek përpjekjet falso të Kosovës për anëtarësim. Vetëm Bakoyannis greke na dilte e mirë (në diskursin qeveritar), ndërsa të gjitha shtetet perëndimore që e kanë njohur Kosovën na dilnin të këqija që nuk e morën parasysh rekomandimin e saj (për pranimin e Kosovës në Këshillin e Evropës). Rekomandimi i saj është, thjesht, rekomandim, s'është urdhër për pranimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Kosova e dinte që nuk do të pranohet dhe ajo përpjekja e fundit, e ditës së fundit për t'i shkruar Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës ishte e barabartë sikur t'i shkruante, ta zëmë, UEFA-s, ose Federatës së Futbollit të Kosovës, se Kosova është e gatshme ta bëjë këtë, këtë, këtë nëse pranohet anëtare. Asambleja e Këshillit të Evropës e ka kryer punën e saj më herët...

Serbia ia doli ta ngrijë konfliktin

RTK: Mendoni se më tepër është bërë për populizëm?

MAVRAJ: Ishte kot, por ishte edhe për problemet e tyre (krerëve të tri institucioneve tona kryesore) me u prish ndër veti ata, ajo treshja e këtij formacioni politik që e udhëheq Kosovën. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe këta duhet ta dinë që po e dimë se në çfarë strategjie janë duke vepruar. Dhe këtë duhet ta dinë se po e dimë se duke folur tërë kohën për detaje të vogla po fshehin diçka shumë të madhe. Serbia vetëm një qëllim e ka pasur, një objektiv, faktikisht, në këtë periudhë: që, si në çerekshkullin e çlirimit, Kosova të jetë pa njohje nga Serbia, as de-jure as de-facto, të jetë problem i ngrirë, konflikt i ngrirë ndërkombëtar, i cili kur e prek 25 vjetëshin shpresohet ta prek edhe 50

vjetëshin si të tillë dhe ajo e di se po e njohu de-jure Kosovën më s'mund ta kërkojë kurrë kthimin e Kosovës. Po e mbajti kështu të zvarritur me këso tensionesh, qoftë artificiale, qoftë të krijuara në mënyra të tjera ajo i ka arritur objektivat e veta. Ky është edhe interes rus, nuk don që të ketë zgjidhje të problemit të Kosovës, as me ndërrim të territoreve që do ta zgjidhte eventualisht njëherë e përgjithmonë këtë çështje, as me njohje të Kosovës dhe Serbisë anasjelltas, që e zgjidh njëherë e përgjithmonë këtë çështje. Asnjë lloj zgjidhje që e nxjerr Rusinë nga Ballkani. Po ashtu edhe Serbia. Ajo shpreson se sikurse ka pritur 500 vjet largimin e turkut të kthehet këtu. Sikurse ka pritur largimin e Austro-Hungarisë, largimin e Italisë, largimin e Gjermanisë, prapshpreson se do të kthehet... Sigurisht, tash jemi shtet, nuk jemi si më parë, do të jetë pak më ndryshe, por po sillemi brenda qejfeve, strategjive të saj. Kosova sa më shpejt duhet t'i tejkalojë konfliktet, problemet që i ka. T'i integrojë pakicat e veta brenda sistemit të vet, ashtu që të fitojë të drejtën e integritetit të vetvetes në institucionet euroatlantike, në radhë të parë në NATO si synimi ynë kryesor strategjik.

RTK: ...sepse kjo pësia e njohjes aspo mosnjohjes nga Serbia do ta ulte këtë nëse eventualisht anëtarësohemi si Kosovë dhe pjesë tjera të Ballkanit Perëndimor në BE, ndonëse kjo tash kërkon goxha kohë, goxha vite...

MAVRAJ: Jo Valon, kjo ka qenë kështu...

Serbia është liruar nga presioni i njohjes së Kosovës

RTK: Është përmendur disa vite si strategji e bashkësisë ndërkombëtare...

MAVRAJ: Po. Ka qenë kështu deri

para pesë vitesh, para 7-8 vitesh, jo më, sidomos jo me këtë marrëveshjen e Ohrit që është menduar që të jetë një lloj hije e atij planit gjermano-gjerman ose e asaj marrëveshjes gjermano-gjermane që ishte. Serbia përjashtohet nga obligimi për njohjen e Kosovës, qoftë de-jure, qoftë de-facto. Këta po e quajnë si njohje de-facto (Marrëveshjen e Bruksel-Ohrit), por edhe po të jetë de-facto, njohja de-facto tërhiqet në çdo kohë. Njohja de-jure nuk tërhiqet kurrë. Serbia e din këtë, pavarësisht se po pretendon se ka bërë disa "çnjohje" të Kosovës. Nuk ekziston ky koncept, i "çnjohjes", sepse njohja bëhet vetëm një herë. S'mund një herë ta njohësh një shtet, ta çnjohësh, ta njohësh prapë, ta çnjohësh prapë. Jo, jo, jo! E drejta ndërkombëtare, zakonet ndërkombëtare nuk e njohin këtë lloj të sjelljes. Serbia është liruar nga ky obligim, në radhë të parë, para së gjithash, me marrëveshjen e Ohrit dhe më atë aneksin që e përcjellë këtë marrëveshjen e Ohrit, e cila në fakt është e Brukselit, por me aneksin në Ohër. Për fat të keq është kështu. Ajo është liruar nga ky presion, prandaj e ka luksin që të bëjë manovra të cilat herë pas here i shohim në terren.

RTK: Profesor, kur ishim tek Asociacioni dhe proceset e tjera duhet një unitet i lidhshëm kosovar, por edhe i spektrit politik tjetër në opozitë. A mendoni se ka dakordime, sidomos ndaj lidhshimit kosovar, sepse e pamë ditë më parë edhe një deklaratë të presidentes Osmani e cila ia bëri me dije kryeministrit Kurti se ajo është udhëheqësja e politikës së jashtme dhe idetë mbi procedimin tutje, në fakt, të elementeve që kanë të bëjnë me themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe së pari duhet të shkojnë për shtrim në tavolinën e saj edhe pse

kryeministri i ka përgjegjësitë për procesin e dialogut...

MAVRAJ: Për dialog po (Qeveria), për politikë të jashtme i ka disa (kompetenca) edhe Parlamenti, diçka ka Qeveria, diçka kryetari i shtetit. Ajo ia ka bërë këto me dije, por edhe një fjali tjetër kur ishte rasti te Këshilli i Evropës, e ka përmendur diçka një kukull ruse, edhe shtetin autoritar, se ishte mënyra qysh e ka përdorur, konteksti kur e ka përdorur m'u duk se po i drejtohet dikujt tjetër këtu. Ishte interesante kjo, por unë i shoh si manovra shumë të vonuara këto për shkak se këta kanë ardhur si ekip dhe duhet të rrinë si ekip dhe të shkojnë si ekip. Nuk e ndihmojnë gjë Kosovën as këto. Është shumë vonë tani dhe është shumë vonë në kuptimin e vetëpërfundimit (nga treshja) nga dështimet e deritanishme. Ajo ka staf të mjaftueshëm që të dinte çfarë është dashur të dijë institucioni i Presidentit të shtetit. Të gjitha këto veprime që janë bërë në këto 3-4 vite, pa i përmendur pasojat e brendshme, zbrazjen e Kosovës, etj., etj., se sot është jubile dhe nuk po dua ta nxijë këtë moment, ajo i ka ditur këto gjëra dhe nuk ka reaguar me kohë, dhe është dashur të reagojë me kohë edhe mbi bazën e kompetencave të veta sa i përket politikës së jashtme, por edhe si kryetare e shtetit, sepse këto transaksione që janë bërë në marrëveshjen e Ohrit, sidomos ajo pika e shtatë është shumë e rrezikshme, ajo është shumë më shumë se Asociacioni për të cilin gjoja po bëhet njëfarë lloj rezistence. Nëse arrijnë ta zhbëjnë pa i bërë dëme më të mëdha Kosovës do të ishte fitore shumë e madhe, pra pikën shtatë, sepse pika shtatë siç e thonë edhe juristët me renome këtu, njohës shumë të fortë të këtyre çështjeve, shkon përtej Asociacionit, - deri në krahinë autonome politiko-territoriale...

Pika 7 e Bruksel-Ohrit është e rrezikshme

RTK: *Është fjala tek vetëmenaxhimi?*

MAVRAJ: Ashtu. Emrin ia kanë lënë “vetëmenaxhim” (i komunitetit serb), por faktikisht ajo shkon thellë-thellë drejt krahinës autonome politiko-territoriale. Sigurisht kjo nuk kalon në Gjykatën Kushtetuese. Ne vetëm po humbim kohë, ne vetëm po e bëjmë atë që po e do Serbia, të zvarrisim, të humbim kohë, qoftë duke na krijuar neve përshtypjen sikurse ja, përkohësisht derisa të mbahen zgjedhjet lokale atje në veri, shqiptarët atje po bëjnë çfarë po duan sikur në Prishtinë dhe gjëra të tjera. Këto gjëra mund ta mashtrojnë Kosovën, mund të jetë kurthi jonë i madh, kurthi i Kosovës. Për 25-vjetor është vështirë ta këtë imagjinuar dikur Serbia që ka me pasë Kosovën të panjohur nga vetvetja si shtet dhe të paintegruar në institucionet evropiane. Ne jemi shumë pak të integruar ndërkombëtarisht.

Jam kundër zgjedhjeve të parakohshme, kjo temë mbuloi dështimin e çështjes së Këshillit të Evropës

RTK: *Profesor, në skenën politike çfarë po ndodh? Ditëve të fundit apo javëve të fundit kemi parë deklarata, ku është bërë goxha bujë në lidhje me mundësinë e shkuarjes së vendit në zgjedhje të parakohshme. I pamë disa propozime edhe nga kryeministri për shpërndarjen e Kuvendit që u përkrahë nga PDK-ja, por që u kundërshtua nga LDK-ja dhe AAK-ja sipas të cilave në zgjedhje mund të shkohet vetëm në*

rast se jep dorëheqje kryeministri Kurti.

MAVRAJ: Ne edhe më parë e kemi pasur në këtë studio çështjen e zgjedhjeve të parakohshme. Kam qenë kundër dhe jam kundër dhe do të mbesë kundër tyre, qoftë me atë model, qoftë me këtë model.

RTK: *Atëherë, pse mendon se është shtruar si temë kjo pikërisht në këtë kohë...?*

MAVRAJ: Kjo është shtruar për ta mbuluar dështimin në Këshillin e Evropës. Kanë shpikur një temë të re që të harrohet një dështim i madh. Shpiku një temë të madhe për ta harruar një dështim të madh dhe kështu do të bëjnë edhe në të ardhmen.

RTK: *A ka të bëjë edhe me zvarritjen e themelimit të Asociacionit, ndoshta eventualisht mund të ketë një bashkëqeverisje?*

MAVRAJ: Jo, nuk e besoj në këtë rast. Në këtë rast nuk e besoj. Në këtë rast është punuar për ta mbuluar dështimin në Këshillin e Evropës dhe këtu mendoj se PDK-ja gaboi në kontekst. Nuk jam kundër takimeve (si ai i kryetarit aktual të PDK-së me kreun e Qeverisë), por për momentin gaboi që pranoi të shfrytëzohet në këtë funksion (qëllim). Jam kundër zgjedhjeve të parakohshme, sepse ky koalicion ka një shumicë shumë të madhe në krahasim me koalicionet tjera të mëparme. Kjo qeveri vjen me 50 për qind të votave. Qytetarët duhet të mësohen që të votojnë për katërvjetëshin e ardhshëm. Nëse kjo qeveri u pëlqen le ta votojnë prapë kur të vjen ai 14 shkurti tjetër, i vitit të ardhshëm që është. Nëse nuk u pëlqen le ta mendojnë mirë

kujt po ia hedhin votën, sepse Kosova nuk e ka luksin që të mbajë kaq shumë zgjedhje të parakohshme, as lokale, as të përgjithshme, por i duhet qeveri stabile që i qaset programit të vet dhe askush më nuk i jep rast askujt që dështimet e veta t'i arsyetojë me zgjedhje të parakohshme. Është gabim i madh vetëm të diskutohet. Dëmet janë bërë nga ky koalicion. U bë çfarë u bë, u nënshkrua çfarë u nënshkrua, u premtua çfarë u premtua, u dështua çfarë u dështua, i morëm ato sanksione që i morëm. Më zi s'ka ku të shkojë. Zgjedhjet e ardhshme janë në 6-7 muajt e ardhshëm, të rregullta. Nuk ka pse t'i jepet asnjë mundësi e arsyetimit për dështimet e veta kësaj qeverie ose cilësdo qeveri. Do të jem gjithmonë kundër zgjedhjeve të parakohshme.

Kjo opozitë nuk është e përgatitur, por besoj në Bedri Hamzën

RTK: *Pa dashur të predikojmë epilogun ose këtë proces, si e shihni, mendoj, qeverisjen e ardhshme pas zgjedhjeve ndonëse nuk dihet nëse do të shkojnë këtë vit ose të presim deri tek afati i rregullt?*

MAVRAJ: Një nga arsyet se pse jam kundër zgjedhjeve...

RTK: *Po më intereson se a do të ishte me frytdhënëse nëse do të kemi një bashkëqeverisje në mes të dy subjekteve edhe për shkak të proceseve të tjera që lidhen me obligimet ndërkombëtare që kemi?*

MAVRAJ: Shiko, gjurmët e vetëdijes shtetërore në partitë e vjetra, në LDK dhe në PDK veçse po zbehen, po shkojnë drejt zhdukjes. Është një

tendencë për shpëputje totale nga liderët pararendës, nga figurat pararendëse ose nga baballarët e partive të tyre, të cilët janë të shumë, dhjetëra, qindra, mijëra që sot nuk i gjejmë as në safat e parë e as të fundit. Nuk i ftojnë nëpër manifestime. I çnderojnë në komunikime publike, i ofendojnë në komunikime publike këta zyrtarët aktualë, sidomos në LDK, e kështu me radhë. Kështu që kjo është pyetje që nuk do ta merrte përgjigjen që do ta merrte po të ishin siç kanë qenë disa gjëra. Tani një ndër arsytet pse jam kundër zgjedhjeve të parakohshme është edhe mospërgatitja e duhur për një katërvjeçar të ardhshëm e kësaj opozite. PDK-në e kuptoj deri diku për shkak se disi është në pritje, nuk i ka liderët këtu, pret çfarë do të ndodhë me ta, por në mungesë të tyre ka mundur të jetë pak më aktive, pak më e pjekur, më bindëse, më shpresdhënëse për opinionin që është gjithnjë më i pakënaqur. Ndërsa, në LDK nuk po e shoh pjekurinë e duhur që duhet ta kishte ky lidërsip që e ka. Më shumë është lidërsip grindavec që i thellon... Unë e pash fjalorin e Abdixhikut, respekt, por kjo çështja e së “majtës që u bë bashkë”, pastaj e “të djathtës”... Nuk luhen më ato karta, është diçka tjetër tani. Kosova është në një moment shumë-shumë kritik. Në qoftë se synojmë 2028-shin, 2030-shin për integrim, ne duhet të luajmë pak më ndryshe. Prandaj, po them se edhe po të mbahen zgjedhjet, edhe po t'i fitonin, nuk i shoh shumë të përgatitur për katërvjeçarin e ardhshëm. Unë kam shpresa shumë më shumë te Bedri Hamza, i cili po të dëgjohej kur ishte fillimi i

pandemisë, Kosova nuk do të ishte në këtë pikë ku është sot në planin ekonomik me gjithë këta njerëz që mbetën pa punë dhe ikën nga Kosova shumë përpara se të liberalizoheshin vizat evropiane, por deri këtu ku ka mbërritur Kosova një Bedri Hamze me dy-tre kolegë që i shoh në LDK, të asaj fushe, ndoshta dy mandate do t'i duheshin që ta kthejë Kosovën në binarët e vet. Njerëzit ende nuk e dinë, sepse mashtrohen nga statistikatat dhe sapo qeveria të përmend statistika aty fillojnë të gënjejnë, pra kur qytetarët ta shohin bilancin e saktë të këtyre që po e paguajnë me kurrizin e tyre, me varfëri të skajshme, me të vërtetë do të shokohen. Ka mundësi që të reagojnë edhe në mënyra të pakëndshme. Aktualisht nuk ekziston dikush që i vetëdijeson këta qytetarë nga këto subjekte opozitare, që i vetëdijeson saktë për gjendjen e tyre ku janë, sepse ata nuk shohin analiza dhe studime të besueshme, sepse s'i bëjnë fare këta opozitarë për situatën ekonomike në të cilën kanë rënë qytetarët. Ka qenë shumë me ndryshe më përpara. Pagat kanë mbetur ku kanë qenë, ndërsa çmimet për artikujt bazikë kanë shkuar në stratosferë.

RTK: *Profesor edhe një herë kënaqësi që sonte ju kishim në “Lajmet e fundit” në Televizionin Publik. Ju faleminderit edhe një herë për prezencën dhe kohën!*

MAVRAJ: Shumë faleminderit prej jush! Do të doja të flisja me tonet me optimiste të mundshme, por realiteti është ky.

RTK: *Faleminderit shumë!*



Hetimi i krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, Sveçla dhe Haxhiu vizitojnë Policinë e Kosovës



PRISHTINË, 14 QERSHOR - Zëvendësdirigjenti i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti, së bashku me stafin e lartë menaxhues, pritën në takim zyrtar ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla dhe ministrin e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.

Fokusi i vizitës së ministrave, përveç tjerash, ishte te Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Luftës, për të parë nga afër punën, angazhimin dhe përkushtimin e

kësaj drejtorie në hetimin e krimeve të kryera gjatë luftës dhe sjelljen para organeve të drejtësisë së personave të dyshuar të cilët kanë kryer krime e gjenocid në Kosovë.

Duke folur për drejtësi për viktimat dhe shoqërinë lidhur me krimet e luftës përfshirë dhunën seksuale, të përdorur si armë lufte në Kosovë, u vlerësua se duhet shtuar edhe më tej angazhimin e përbashkët të hetimit, arrestimit dhe procedimit penal

të të gjitha rasteve të krimeve të luftës tek organet e drejtësisë. Në takimin e përbashkët me stafin e lartë menaxhues, pjesë e të cilit ishin edhe stafi i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Luftës, u ritheksua zotimi për të mos reshtur së hetuari e kërkuari drejtësi për krimet e luftës, si dhe u ofrua mbështetje e plotë ndaj Policisë së Kosovës, e në veçanti ndaj kësaj drejtorie mjaft të rëndësishme.

Serbia të mbahet përgjegjëse për gjenocidin në Kosovë

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, ka pritur të premten në takim përfaqësues të Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të Zhdukurve të Kosovës.

Përgjatë bisedës, fillimisht u përshëndet bashkërisht miratimi i rezolutës në muajin maj në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për njohjen e gjenocidit serb në Srebrenicë dhe shënimin e 11 korrikut si "Ditë Ndërkombëtare e Përkujtimit të Viktimave të

Gjenocidit të Srebrenicës". E njëjta dënon mohimin e gjenocidit dhe glorifikimin e kriminelëve të luftës.

U theksua rëndësia e ndërkombëtarizimit edhe të gjenocidit të kryer nga Serbia në Kosovë, për të cilën organizatat mund të mbështeten plotësisht në përkrahjen e Qeverisë, si dhe u nënvizua domosdoshmëria për zbardhjen e krimeve, masakrave dhe planeve të strukturuar të saj për spastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës e vënia para drejtësisë e përgjegjësve të krimeve. "Republika e Kosovës

vijon në përpjekjet e saj të pareshura institucionale në këtë drejtim, por i cili fatkeqësisht përballet me mosgatishmëri, mohim dhe hezitim nga autoritetet serbe për zbardhjen e tyre. Serbia, tashmë e njohur ndërkombëtarisht si shtet gjenocidal, duhet të përballet me të kaluarën dhe të mbahet përgjegjëse për gjenocidin në Kosovë", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Pjesëmarrës në këtë takim ishte dhe drejtuesi i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Andin Hoti si dhe Kushtrim Gara.



Limaj në Malishevë kërkon nga anëtarësia të jenë të gatshëm për proceset e ardhshme politike

MALISHEVË, 14 QERSHOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, së bashku me kryetarin e Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, anëtarin e kryesisë qendrore Xhevahire Izmaku, kryetarin e degës Hajdin Berisha, nënkryetarin Vesel Krasniqi dhe drejtoresha Arbëreshë Krasniqi, dhe drejtues tjerë të forumit të gruas në Malishevë, kanë zhvilluar një bashkëbisedim me gratë dhe vajzat intelektuale të partisë sonë politike në këtë qytet.

Kryetari Limaj, në fjalën e tij të rastit, fillimisht ka shprehur mirënjohje të thellë për secilën



grua dhe vajzë të partisë Nisma në qytetin e Malishevës, që për më shumë se 10 vite kanë qenë

shtylla kryesore e organizmit dhe sukseseve të partisë, në të gjitha proceset politike nëpër të cilat ka

kaluar vendi ynë.

Gjithashtu, kryetari Limaj, ka kërkuar që struktura e forumit të gruas në Malishevë, të vazhdojë të zgjerohet edhe më shumë, në mënyrë që të jetë e gatshme për proceset e ardhshme politike, si Nismë Socialdemokrate, gruaja do të zë një vend të fuqishëm në programin e saj që do t'u ofrohet si alternativë shumë e mirë për qytetarët e vendit tonë pa dallim.

Një fjalë rasti, ka mbajtur edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, i cili mes tjerash theksoi se duhet të punojmë të gjithë bashkë që sa më parë, përmes proceseve politike, të

rikthejmë fuqishëm zërin e grave të Nismës në Parlament, dhe të avancojmë sa më shumë pozitën e gruas në shoqërinë tonë.

Gjithashtu, para të pranishmëve, dhe për kontributin e madh të grave dhe vajzave të Nismës në Malishevë, ka folur edhe kryetari i degës Hajdin Berisha, anëtarja e kryesisë qendrore Xhevahire Izmaku, nënkryetari Vesel Krasniqi dhe drejtoresha e Arsimit, Arbëreshë Krasniqi, ku kanë kërkuar që të ketë një mobilizim sa më të madh në përkrahje të projektit politik që drejtohet nga lideri i partisë sonë, Fatmir Limaj.

AUV apel qytetarëve: Therjet e kurbanëve të bëhen vetëm në thertore të licencuara

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka bërë apel që therja e kurbanëve të bëhet vetëm në thertoret e licencuara.

AUV thekson se therja e kurbanëve jashtë këtyre objekteve përben shkelje ligjore, duke rrezikuar shëndetin e përgjithshëm publik. "Të nderuar qytetarë të besimit islam me rastin e festës së "Kurban Bajrami" e cila festohet me datë 16 Qershore e Diele. Ju apelojmë që therjen e Kurbanëve ta bëni vetëm në thertoret e licencuara nga Agjencia e Ushqimit dhe

Veterinarisë. Therja jashtë këtyre objekteve, përveçse se përben shkelje ligjore ajo rrezikon shëndetin e përgjithshëm publik. Tani që po mbretërojnë temperatura të larta, rrisin rrezikun e kontaminimit të produkteve që i ekspozohen të nxehtë, thuhet në njoftim.

AUV sqaron se objektet e thertoreve përveç se janë nën mbikëqyrje kontrolli, ku secila kafshë i nënshtrohet inspektimit para therjes, gjatë procesit të therjes dhe pas therjes, ato posedojnë frigoriferë, kushte teknike

sanitare dhe higjienike. "Në transport të përdorin mjete adekuate duke respektuar kushtet për mirëqenie të kafshëve. Tregtimet të bëhen në tregjet e autorizuar ose blerjet direkte nga ferma, tregtimet në hapësira tjera do të pengohen dhe ndëshkohen. Në të gjithë vendin janë mbi 50 objekte të aprovuara për therjen e kafshëve, të cilat kanë kapacitete të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e qytetarëve", vijon njoftimi.

Më tej, AUV shton se "duhet secili ta ndiejmë si obligim që mos të krijojmë imazhe të



prerjes-therjes së kafshëve në hapësira publike, në mënyrë jo humane dhe në kushte jo

higjienike". Festa e Kurban Bajramit do të jetë më 16 qershor.

Përurohët shërbimi i Kardiologjisë Intervente në Spitalin e Prizrenit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRIZREN, 14 QERSHOR - Në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit u përrua shërbimi më i ri i Kardiologjisë Intervente, ngjarje në të cilën mori pjesë kryeministri i Albin Kurti, zëvendës-kryeministrja, Emilija Rexhepi, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, si dhe ambasadori i Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz.

Shërbimi i cili fillon nga sot dhe që u cilësua jetik nga kryeministri Kurti, u funksionalizua falë bashkëpunimit të Qeverisë së Luksemburgut e cila ka ndarë 2 milionë euro, dhe Ministrisë së Shëndetësisë, përkatësisht ShSKUK-së me investim që kap vlerën rreth 1 milion euro. "Tash shërbimi i ri do të mbulojë të gjithë rajonin e Prizrenit, do të ndihmojë të shpëtojë jetë dhe ta ulë listën e pritjes. Fillimisht, shërbimi do të trajtojë pacientët nga lista e pritjes së rajonit të Prizrenit, ndërkaq rastet akute do të trajtohen menjëherë", ka deklaruar kryeministri, i cili shtoi se ky investim përfshin të gjitha pajisjet e nevojshme mjekësore, inventarin dhe trajnimet profesionale për stafin brenda dhe jashtë Kosovës.

Krahas reduktimit të kohës së

pritjes së pacientëve, pritshmëritë për rezultatet nga ky investim janë edhe shërbimet me cilësi të lartë e me kosto minimale për qytetarët, derisa pritet që shërbimi të ketë ndikim edhe në uljen e shkallës së vdekshmërisë në rajonin e Prizrenit.

Kryeministri Kurti vlerësoi se zgjerimi i këtij shërbimi është i domosdoshëm jo vetëm për shkak të rritjes së numrit të rasteve, por edhe meqenëse suksesi varet shumë nga koha e ndërhyrjes. "Në vitin 2023 kemi pas performancë rekorde. Kemi pasur në shërbimin tonë të Kardiologjisë mbi 4,100 procedura të kryera, përfshirë këtu 2,500 vendosje stentesh. Ndërkaq, 4 vjet më parë, në vitin 2019, ishin 3,300 procedura dhe mbi 1,700 vendosje stentesh", shpjegoi tutje ai.

Falënderime dhe mirënjohje kryeministri shprehu për Qeverinë e Luksemburgut dhe personelin shëndetësor, derisa i uroi të gjithë për inaugurimin e sotëm.

Ngjashëm, drejtoresha e Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit, Narqize Arenliu Hoxhaj, duke falënderuar Qeverinë e Luksemburgut dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës tha se dita e sotme është një ngjarje me



rëndësi të veçantë sepse ky shërbim ofron mundësi që të shpëtojë jetë, pasi që reagimi adekuat dhe i shpejt është i rëndësishëm në emergjencat kardiake.

Në anën tjetër, duke theksuar se kujdesi shëndetësor është e drejtë fundamentale e njeriut,

Ambasadori i Luksemburgut, Eric Dietz, deklaroi se Spitali i Përgjithshëm i Prizrenit është një dëshmi e përpjekjeve tona të përbashkëta dhe bashkëpunimit drejt qëllimit tonë për të krijuar spitale dhe infrastrukturë moderne. "Luksemburgu ka mbështetur sektorin shëndetësor

të Kosovës për pothuajse dy dekada dhe kontribuoi në ndryshime thelbësore në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor", shtoi ai duke u shprehur i lumtur që sot së bashku po shohim rezultatet e arritura si produkt i bashkëpunimit.

Në Kosovë fillon të jepet terapia për parandalimin e infeksionit nga virusi HIV

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Nga kjo javë, në Kosovë ka nisur të jepet terapia për parandalimin e infeksionit para ekspozimit ndaj virusit HIV, konfirmoi për Radion Evropë e Lirë Murat Mehmeti, shef i repartit për sëmundje seksualisht të transmetueshme në Klinikën Infektive në Prishtinë.

Virusi HIV e dëmton sistemin imunitar të personit të prekur, duke e lënë atë të ekspozuar ndaj infeksioneve të rënda.

Virusi mund të transmetohet nëpërmjet shkëmbimit të lëngjeve të ndryshme trupore nga individët e infektuar.

Terapia "PrEP" (profilaksia para ekspozimit) është medikament, i cili përdoret te njerëz që janë HIV



negativ, për të zvogëluar rrezikun e marrjes së virusit.

Sipas Mehmetit, terapia në formë të tabletave, fillimisht do

t'u jepet personave LGBTI+, por edhe të tjerëve që e kanë partnerin pozitiv me HIV, ose kanë nevojë për të.

Sigurimi i kësaj terapie ka qenë një projekt i përbashkët i institucioneve të Kosovës, Fondit Global (Global Fund) dhe Qendrës për Zhvillimin e Grupeve Sociale nga Prishtina, tha Mehmeti.

Organizata ndërkombëtare financiare, Fondi Global, me fokus në parandalimin si dhe trajtimin e të sëmurëve me HIV/AIDS, i ka siguruar barna për dy vjet. Pas kësaj periudhe, Ministria e Shëndetësisë e Kosovës do ta marrë përsipër sigurimin e tyre, shpjegoi ai.

Terapia në formë tabletash me paketim 30 copë, do të mund të merret në barnatoren e Klinikës Infektive, pas konsultimeve me mjekun.

Agron Nuhiu, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Zhvillimin e Grupeve Sociale, tha për Radion Evropë e Lirë se në këtë projekt është punuar prej vitit 2016.

Kosova, sipas Nuhiut, është shteti i dytë në rajon që e ofron këtë terapi falas, pas Maqedonisë së Veriut.

Dita Ndërkombëtare e Luftës Kundër HIV/AIDS-it, më 1 dhjetor 2023, e ka gjetur Kosovën me 13 raste të reja të personave të prekur me këtë virus gjatë atij viti.

Në vitin 2022 në Kosovë ishin shënuar 17 raste të reja me HIV/AIDS - shifër që paraqiti dyfishim rastesh në krahasim me vitin 2021, kur ishin regjistruar tetë të tilla.

Këtë vit SBASHK-u dërgon 440 anëtarë në bregdetin shqiptar

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Edhe këtë vit SBASHK-u ka vazhduar me aktivitetin tradicional për dërgimin e një numri të konsideruar të anëtarëve e anëtarëve në bregdetin shqiptar në shenjë të respektit për përkushtimin e tyre në arsimimin dhe edukimin e brezave nëpër vite e dekada.

Ky aktivitet këtë vit ka nisur të premten me grupin e parë

prej 88 pushuesve, për të vazhduar më 19 qershor me grupin e dytë prej 203 pushuesve dhe për t'u përmbyllur me grupin e tretë prej 149 pjesëmarrësve në këtë aktivitet rekreativ, të cilët për në bregdetin shqiptar do në nisen më 29 qershor.

Përzgjedhja e pushuesve është bërë nga shoqatat sindikale që nga çerdhet e deri të universitetet e



institucionet e kulturës, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara nga Këshilli Drejtues i SBASHK-ut.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, është krenar që ky aktivitet po vazhdon sepse është shprehje e mirënjohjes për angazhimet e vazhdueshme e maksimale të këtyre pushuesve në shërbim të arsimit dhe kulturës.

ATK-ja, pjesëmarrëse në takimin vjetor koordinues në Vjenë

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka marrë pjesë në takimin vjetor koordinues në Vjenë, i organizuar nga Departamenti për Çështje Fiskale DÇF - Fondi Monetar Ndërkombëtar FMN, Drejtorja e Përgjithshme e KE-së për Fqinjësi dhe Negociata të Zgjerimit (DG NEAR) si dhe SECO.

Ky takim zhvillohet ndërmjet vendeve përfituese, partnerëve zhvillimorë dhe FMN-së i cili është komponent kyç për koordinimin e përpjekjeve për

reformë, dhe është një mundësi e mirë për përfituesit e programit të zhvillimit të kapaciteteve për të ndarë përvojat dhe sfidat e tyre në zbatimin e reformave fiskale dhe për të diskutuar për prioritetet e tyre reformuese për të ardhmen.

Qëllimi i këtij takimi është diskutimi mbi progresin në zbatimin e programit të fazës tretë të reformave fiskale në Evropën Juglindore 2023-2026, të kuptohen më mirë perspektivat e autoriteteve mbi përpjekjet dhe prioritetet e reformës për të informuar

mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve.

Departamenti për Çështje Fiskale i FMN-së ka përgatitur dhe prezantuar dokumentin krahasues rajonal mbi çështjet me interes rajonal, për të paraqitur kontekstin për ndërhyrjet e autoriteteve nga vendet pjesëmarrëse.

Murtezaj gjatë fjalës së tij ka falënderuar FMN-në dhe partnerët zhvillimor për mundësinë e ofruar dhe kontributin e dhënë deri më tani, si dhe ka kërkuar përkrahjen e mëtutjeshme për reforma në ATK.



FKEE fillon shqyrtimin e listës së pritjes për subvencionimin e investimeve në shtëpitë individuale

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjise (FKEE) ka njoftuar ka filluar shqyrtimi i listës së pritjes për aplikantët që kanë shprehur interesimin vitin e kaluar për të përfitur nga subvencionimi i investimeve për implementim të masave të energjisë eficiente në shtëpitë individuale.

Thirrja fillestare për përfitim nga subvencionimi i mundësuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Kosovës, ka qenë aktive nga data 8 gusht 2023 deri më 25 shtator 2023 dhe në bazë të kushteve të thirrjes, konkretisht të pikës 2.1 "Aplikimi pa Raport të Auditimit të Energjisë", është thënë se: "Në rast se aplikanti, për çfarëdo arsye, nuk ka gjetur një auditor të certifikuar të energjisë për të bërë auditimin e thjeshtëzuar të energjisë (walk-through audit), ai aplikacion do të vendoset në listë të pritjes, ndërsa shqyrtimi i tij i mëvonshëm do të merret parasysh nëse plotësohen dy kushtet e mëposhtme: Buxheti i destinuar për thirrjen ende nuk është shpenzuar; dhe Kontraktimi i Auditorëve të Energjisë bëhet nga ana e FKEE-së".



Në lidhje me këtë, në mënyrë që të përmbushet ky kusht i thirrjes, FKEE fton të gjithë aplikantët në listën e pritjes, e që janë rreth 1000 sosh, të njoftojnë FKEE-në nëse ende janë të interesuar për të përfitur nga subvencionimi i implementimit të Masave të Eficiencës së Energjisë (MEE).

Për të gjithë të interesuarit, rikujtojmë se kriteret që kërkohen për t'u kualifikuar për subvencionimin, janë: Shtëpia të jetë e banueshme në 21 nga 24 muajt e fundit (si kriter bazë), e që ka një konsum energjie të energjisë elektrike prej të paktën 250 kWh (kilovat/orë) në muaj.

Gjithashtu, duhet të plotësohet së paku njëri nga kriteret: a) shtëpia nuk ka termoizolim ose është nën kërkesat minimale teknike (trashësia e izolimit të murit të jashtëm është nën 8 cm, termoizolimi i kulmit nën 10 cm, dhe shtëpia ka dyer e dritare jo efikase); ose b) shtëpia është

pjesërisht e izoluar, por një ose më shumë nga masat e pikës a) nuk i plotësojnë kërkesat minimale.

Në bazë të Rregullores së MESPI nr.04/18 për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave, izolimi termik i mureve të jashtme mbetet një kriter i detyrueshëm në të gjitha rastet. Kjo do të thotë që nëse aplikanti nuk do të investojë në termoizolim, masat e tjera nuk do të miratohen.

Në mënyrë që procesi të jetë sa më i shpejtë, efikas dhe transparent, njoftojmë të gjithë aplikantët në listën e pritjes që të kontrollojnë postën e tyre elektronike (e-mail), në të cilën, me datë 14 qershor 2024, do të pranojnë njoftimin dhe kërkesën që të shprehin interesimin e tyre për të vazhduar tutje me procesin. "Njëkohësisht, bëjmë me dije që mungesa e ndonjërisht nga informatat e kërkuara në email, do të rezultojë me diskualifikim të kërkesës për trajtim të mëtutjeshëm. FKEE pret konfirmime nga të gjithë aplikantët e listës së pritjes, nga e premtja e datës 14 qershor 2024 deri të dielën e datës 23 qershor 2024", ka njoftuar FKEE.

Ish-punonjësit e "Rilindjes" protestojnë para AKP-së për 20 përqindëshin, kërkojnë të drejtat e tyre

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Ish-punonjësit e NGB "Rilindja" kanë protestuar të premten para objektit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për mosrealizimin e të drejtave për 20 përqindëshin. Ata thonë se AKP-ja po i diskriminon ata duke mos e bërë pagesën e një pjese të mjeteve që qeveria i ka ndarë për punëtorët e "Rilindjes". Në protestën simbolike, këta punëtorë kërkuar që të realizohet edhe 20 përqindëshin nga trualli, sepse sipas tyre bashkë me objektin, qeveria i ka marrë 5.5 hektarë truall.

Zeqir Bekolli tha se ndër kërkesat e tyre është edhe lirimi i objekteve të uzurpuara në Tiranë.

Ai potencoi se AKP-ja duhet paguar kontributet për periudhën pas viteve të '90-ta. "Sot kemi dalë ta shprehim pakënaqësinë tonë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit në raport me 'Rilindjen', sepse këta po vazhdojnë të na diskriminojnë. Vazhdojnë të mos e bëjnë pagesën e një sasive të mjeteve që qeveria i ka derdhur për nevojat e 20 përqindëshit për punëtorët e 'Rilindjes'. Madje, ne

kërkojmë që të realizojmë edhe 20 përqindëshin nga trualli, sepse bashkë me objektin qeveria i ka marrë 5.5 hektarë truall. Ne kërkojmë që të na lirohet pasuria që e kemi në Tiranë, objektet që janë uzurpuar, edhe këtë mund ta bëjë AKP-ja, sepse tash është në kompetencë të AKP-së. Po ashtu, kërkojmë nga AKP-ja të na i paguajë kontributet për periudhën pas viteve të '90-ta, kur kemi punuar, meqë i ka marrë të gjitha obligimet për "Rilindjen", atëherë u takon që t'i paguajë kontributet dhe të marrim pensionin e plotë", ka thënë Bekolli.



“The New York Times” dhe Shqipëria e vitit 1991: Pritjet e gjata për një litër qumësht



Nga: **David BINDER** / *The New York Times*, 25 mars 1991
(Titulli: Albania Turns In the Throes Of Transition)

Në orën 2:30 të mëngjesit të sotëm, këtu ishin grumbulluar gra dhe të moshuara përpara një dyqani që ndodhej në një nga rrugët kryesore të kryeqytetit, duke pritur deri kur të hapej në orën 8:00 për të blerë racionin e qumështit. Pak kohë më herët, te “Blloku” tutje, presidenti Ramiz Alia kishte mbledhur në një takim special, udhëheqësit e Partisë Komuniste, me arsyen që të hynte në javën finale të fushatës elektorale kombëtare. Aty ishin drejtuesit më të lartë të saj. Në kishat katolike që ishin mbyllur 24 vjet më parë nga qeveria komuniste dhe që janë rihapur së fundmi, këtë të diel kishin shkuar me qindra adhurues për t’u falur.

Gjetkë, 127 të burgosur politikë u liruan nga burgjet një javë më parë dhe iu bashkuan familjeve dhe shokëve të cilët u dhanë atyre veshje, para xhepi dhe një strehë të përkohshme për të futur kokën. Dhe, 90 të burgosur politikë të tjerë vazhdojnë të jenë prapë të mbyllur sot.

Këto ishin pjesët në një “Kaleidoskop” shqiptar që është duke krijuar të ardhmen e shpejtë, pothuaj nga momenti në moment. Ky vend 3.5 milionë banorësh, më i varfri në Evropë, është në grahamat e vdekjes së

trazicionit të dhunshëm komunist 46-vjeçar dhe izolimit të vazhdueshëm.

Një vit më parë, presidenti Alia, 65 vjeç, nisi duke shpresuar drejtimin e reformave të ngadalshme, duke filluar nga maja. Por, kërkesat e njerëzve të tij për demokraci tani dhe nevojat e tyre për përmirësimet themelore në standardet e tyre të jetesës, e kanë nxitur që të ndër marrë një hap më të shpejtë.

Zgjedhjet kombëtare do të mbahen të dielën tjetër [31 mars]

dhe së fundi koalicioni i partive të opozitës tani beson se ata do të mund të rrezojnë komunistët. “Jam realist optimist”, thotë Dr. Sali Berisha, drejtuesi 46-vjeçar i Partisë Demokratike, grupit më të madh opozitar.

Një nga anëtarët e partisë së tij në qytetin verior të Shkodrës, tha të shtunën se një milion nga 1.7 milionë votues janë të rinj dhe ata përkrahin totalisht opozitën. Ai tha se komunistët janë të fortë vetëm në pjesën jugore të vendit dhe te brezi më i vjetër. Kjo është në angazhimet e z. Alia, i cili

është gjithashtu edhe kryetari i Partisë Komuniste. Në turrin elektoral të tij, ai u përpoq të mbajë besnikët e partisë. “Sigurisht, këtu janë bërë gabime”, tha ai në një fjalim të publikuar sot te “Zëri i popullit”, gazeta e Partisë Komuniste. “Madje edhe sot ne jemi duke bërë gabime. Asnjë forcë politike nuk mund t’i shmang ato. Asnjë individ nuk mund të jetë i përsosur”. Z. Alia dukej i përqendruar në përgatitjen e partisë së tij për humbje të mundshme në këto zgjedhje, kur

tha se “Partia e Punës është për bashkëpunim konstruktiv me të gjitha partitë e tjera”.

Në një qëndrim të mbajtur në fund të konferencës së partisë, Alia tha se komunistët do të bëjnë fushatë mbi platformën e të qenit “forca më progresive dhe partia më me eksperiencë” në politiken shqiptare. Kjo e fundit sigurisht që është e vërtetë.

Trazira dhe dhuna ka rrethuar qytetet më të mëdha të Shqipërisë, për disa muaj, duke u mbyllur me dhjetëra të vdekur në Tiranë dhe në Portin e Durrësit. Një eksod masiv nga deti dhe nga toka, ka sjell largimin e 80 mijë shqiptarëve drejt Italisë, Greqisë dhe Jugosllavisë, që në verën e kaluar.


Pakënaqësia ka ndarë familjet, me të vjetrit që janë me Partinë Komuniste dhe të rinjtë që janë duke u kthyer tek opozita. Kristina Budina, studente 21-vjeçare, tha: “Në familjen time, tre anëtarë janë për Partinë Demokratike dhe vetëm babai im është me komunistët”.

Dhe, në fund, zgjedhjet mund të vendosen nga njerëzit që janë në radhë duke pritur për të marrë racionin e qumështit. “Nuk i duam më bolshevikët”, tha një e moshuar teksa ndodhej këtë mëngjes, herët në rrugën “Kongresi i Përmetit”, në një nga bulevardet kryesore të kryeqytetit. Ajo kishte pritur në radhë për katër orë që të merrte një litër qumësht.

/Memorie.al/



EURO GLASS
SAINT-GERMAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Shqipëria sonte debuton në 'Euro 2024'

Kuqezinjtë shqiptarë sonte debutojnë në Kampionatin Evropian që po mbahet në Gjermani. "Signal Iduna Park" do të jetë arenë e përballjes mes Shqipërisë dhe Italisë. Sot përballen edhe Spanja me Kroacinë dhe Hungaria me Zvicrën



një ndeshje shumë të bukur. Ndishja është e vështirë pasi Silvinjo i ka dhënë ekuilibër skuadrës së tij dhe do të luajmë kundër lojtarëve që njohin mirë kampionatin tonë. Ramadani, Asllani, Bajrami, Hysaj e dinë se kush jemi dhe do të jetë një ndeshje e vështirë. Është e vërtetë që shpesh rezultatet janë ndryshe në krahasim me atë që merr me vete në shtëpi, por trajktoret e topit janë të vështira për t'u kuptuar, ose më mirë të themi të ndryshme nga vazhdimësia e ndeshjes. Ne duam të jemi gjithmonë një skuadër, të shprehim emblemën e futbollit tonë, po punojmë në këtë drejtim, por ka edhe kundërshtarë dhe jo gjithmonë ia del. Por unë jam i bindur se do të tregojmë gjithmonë futbollin që duam. Kjo nuk na siguron që mund të arrijmë rezultatit e plotë, por do të na dhurojë ndjesinë që jemi pjesë e një bashkësie. Jo vetëm të atyre që shkojnë në fushë, por edhe të 60 milionë tifozëve tanë", ka thënë Spalletti. Duhet cekur se ndeshja tjetër e këtij grupi mes Spanjës dhe Kroacisë zhvillohet nga ora 18:00, kurse paraprakisht nga ora 15:00 zhvillohet ndeshja e grupit A me Hungarisë dhe Zvicrës.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Dortmund, 14 qershor - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll sonte (e shtunë) e fillon rrugëtimin në Kampionatin Evropian "Euro 2024". Në "Signal Iduna Park" të Dortmundit, kuqezinjtë do të përballen me Italinë nga ora 21:00 në kuadër të Grupit B ku bëjnë pjesë edhe Spanja dhe Kroacia. Para kësaj ndeshje, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama ka paralajmëruar se 50 mijë shqiptarë do të jenë të pranishëm në stadium dhe "Muri i Verdhë" i Borussia do të zëvendësohet për një natë nga "Dallga Kuqezi" e Shqipërisë. "Shqipëria e ka fituar Evropianin e saj dhe s'ka më asgjë për të humbur, prandaj cilido qoftë rezultati i ndeshjes mbrëmja e nesërme do të mbetet jo vetëm në historinë e futbollit shqiptar, po edhe në kujtesën e 10 milionë

GRUPI A
15:00 Hungari - Zvicra

GRUPI B
18:00 Spanjë - Kroaci
21:00 Itali - Shqipëri

shqiptarëve", ka shkruar Rama. Lidhur me kundërshtarin e parë në "Euro 2024", trajneri Sylvinho ka deklaruar se Italia gjithmonë është një kundërshtar i fortë dhe se ndeshjet ndaj tyre janë gjithnjë motivuese për kundërshtarët. "Po flasim për kampionët e Evropës në fuqi, Italia është nga kombëtarët më të forta. E njëjta gjë mund të thuhet për Spanjën dhe Kroacinë. Është një grup i bukur për të gjithë ne, është mundësi që ta shijojmë këtë

pjesëmarrje të dytë në Evropian, të provojmë të bëjmë më të mirën. E kemi ndjekur miqësoren e fundit të Italisë dhe kemi mbajtur shënimet e duhura. Të luash kundër Italisë është një motivim i madh. Edhe unë, kur isha me Brazilin më 1982, e kam parë ndeshjen Brazil-Itali. Brazili e humbi atë ndeshje. Nuk ka nevojë të luash në Serie A për të pasur motivimin e duhur, nuk ka rëndësi ku luan në Spanjë, Gjermani, Bundesligë apo Portugali. Italianët kanë një fanellë të rëndë dhe janë favoritë,

për ne është e rëndësishme të përgatitemi mirë", ka deklaruar Sylvinho. Lidhur me këtë ndeshje ka folur edhe trajneri i Italisë, Luciano Spalletti, i cili e ka parashikuar si të vështirë ndeshjen e parë në Kampionatin Evropian ndaj Shqipërisë. Ai ka thënë se disa prej lojtarëve kuqezinj që luajnë në Serie A e dinë se kush është Italia, por beson se do t'i gëzojnë 60 milionë tifozë italianë. "Emocioni nga pikëpamja ime është i madh, por me kalimin e orëve ky emocion bëhet fantastik dhe jo toksik. Jemi në një vend fantastik për të luajtur

50 mijë tifozë shqiptarë në 'Euro 2024', mediat serbe: Mund të krijojnë kaos në Gelsenkirchen

Gelsenkirchen, 14 qershor - Rreth 50 mijë është numri i shqiptarëve që mbështesin kombëtaren kuqezi në "Euro 2024", ndërsa ndeshjen e parë Shqipëria do e luajë kundër Italisë. Prania e lartë e tifozëve shqiptarë në Gjermani duket se ka shqetësuar mediat serbe, që mesa duket nuk e kanë harruar ende të famshmen "Provokacija". Serbia dhe Anglia do të luajnë takimin e parë të Grupit C në Evropian, të dielën në orën 21:00. Dhe pikërisht nga kjo,

mediat serbe paralajmërojnë se tifozët shqiptarë të stacionuar në Dortmund mund të zhvendosen në Gelsenkirchen, që nuk është shumë larg, për të shkaktuar kaos me tifozët serbë. Korrespondentët e "Blic.rs" nga Gjermania shkruajnë: "sipas njohurive tona, ajo ditë do të jetë shumë e nxehtë", sepse në Dortmund janë 50 mijë tifozë shqiptarë. Shumë prej tyre do të vijnë në Gelsenkirchen aty pranë, ku po luan Serbia, për të krijuar kaos. Në ditën e ndeshjes

sonë me Anglinë, kjo do të jetë një sfidë e dyfishtë për tifozët tanë për të treguar se askush nuk mund t'i provokojë ata, veçanërisht nëse e dimë që po vijnë edhe huliganët anglezë. Dhjetëra mijëra shqiptarë do të jenë në Dortmund sepse kombëtarja e tyre po luan atje një ditë më parë me Italinë dhe kur të jenë tashmë atje, një ditë më vonë do të shkojnë në një qytet aty pranë për



të provokuar serbët". Por, nëse serbët druhën nga prania e madhe e shqiptarëve, mediat

kroate e shikojnë me një sy tjetër këtë realitet. Ja si vlerëson "index.hr": "Një numër kaq i madh i shqiptarëve nuk është për t'u habitur. Ky është vetëm kompeticioni i dytë i madh në histori, në të cilin kombëtarja e tyre është kualifikuar. Ndaj ka eufori në vend dhe të gjithë duan ta shikojnë kombëtaren live në Euro. Përveç kësaj, ka një diasporë të madhe shqiptare në Gjermani dhe në vendet fqinje.

10 talentët më të vlefshëm në 'Euro 2024'

Dortmund, 14 qershor - Janë emëruar dhe renditur tashmë 10 "fëmijët e mrekullueshëm" apo talentët më të vlefshëm në Kampionatin Evropian. Në prag të fillimit të turneut, faqja e specializuar e statistikave dhe transferimeve, "Transfermarkt" ka renditur talentët më të mirë në "Euro 2024". Ata kanë emëruar dhe renditur yjet më të mirë të moshës nën 19-vjeç, duke shfaqur disa prej talenteve më të mirë në futbollin botëror. Leo Sauer i Sllovakisë, i cili luan për Feyenoord, renditet i 10-ti përpara polakut Kacper Urbanski dhe turkut Semih Kilicsoy. Mesfushori Arthur Vermeeren, i cili



luan për Atletico Madridin dhe Belgjikën, dhe ylli i Real Madridit, Ardu Guler, renditen respektivisht në vendin e shtatë dhe të gjashtë. Kobbie Mainoo i Anglisë hyn në listë

si i pesti, pasi ka shkëlqyer në Manchester United sezonin e kaluar. Ai ka një vlerë prej 30 milionë euro. Një përfaqësues i tretë turk, Kenan Yildiz renditet i katërti, ndërsa

10 TALENTËT MË TË VLEFSHËM NË "EURO 2024"

1. Lamine Yamal (Spanjë) - 90 milionë euro
2. Warren Zaire-Emery (Francë) - 60 milionë euro
3. Joao Neves (Portugali) - 30 milionë euro
4. Kenan Yildiz (Turqi) - 30 milionë euro
5. Kobbie Mainoo (Angli) - 30 milionë euro
6. Arda Guler (Turqi) - 30 milionë euro
7. Arthur Vermeeren (Belgjikë) - 25 milionë euro
8. Semih Kilicsoy (Turqi) - 12 milionë euro
9. Kacper Urbanski (Poloni) - 7 milionë euro
10. Leo Sauer (Sllovaki) - 5 milionë euro

objektivi portugezi Joao Neves, i cili ka një vlerë prej 55 milionë euro, renditet i treti. Ylli i Paris Saint-Germain dhe Francës, Warren Zaire-Emery, renditet i dyti

me një vlerë prej 60 milionë euro, ndërsa fenomeni i Barcelonës dhe Spanjës, Lamine Yamal, është talenti më i vlefshëm në Euro 2024, me një vlerë prej 90 milionë euro.

Çeku pret në takim drejtorin për zhvillim në Federatën Ndërkombëtare të Shahut, diskutohen të arriturat në sport

Prishtinë, 14 qershor - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku ka pritur në takim drejtorin për zhvillim në Federatën Ndërkombëtare të Shahut (FIDE), Nigel Short, i cili shoqërohej nga kryetari i

Federatës së Shahut të Kosovës, Armend Budima dhe sekretarja e Federatës Shqiptare të Shahut, Majlinda Pilinci. "Bashkë diskutuan për zhvillimet aktuale në sport, përfshirë këtu organizimin e Lojërave Mesdhetare Prishtina

2030. Çeku e njoftoi për ecurinë e programit 'Sport në Shkollë', ku është i përfshirë edhe sporti i shahut, ndërsa Short u shpreh tejet i lumtur që fëmijët e Kosovës kanë mundësi të mësojnë shahun në shkollë dhe të përfitojnë

benefitet që sjell ky sport tek ta", thuhet në një postim nga MKRS-ja. Të dy shprehën vullnetin dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar për zhvillimin dhe promovimin e mëtutjeshëm të shahut në vendin tonë.



Khaka synon të shkruajë histori në 'Euro 2024' me Zvicrën

Berlin, 14 qershor - Pas një sezoni të parë sensacional në Leverkusen, në të cilin klubi fitoi titullin e parë të Bundesligës dhe fitoi Kupën e Gjermanisë, si dhe arriti në finalen e Ligës së Evropës, Granit Xhaka po përgatitet të udhëheqë Zvicrën në UEFA EURO 2024. Në "Euro 2020", helvetikët i tejkaluan pritshmëritë, duke eliminuar Francën me penallti në 1/8-tën dhe humbi një vend në gjysmëfinale pas një disfate nga Spanja. Skuadra e tij ka të gjitha arsyet për të qenë krenarë për arritjet e tyre, por siç shpjegon mesfushori 31-vjeçar, arritjet e kaluara nuk llogariten shumë për anën e tij ambicioze. "Ndihej si një arritje për ne, për stafin, por edhe për të gjithë Zvicrën. Ndeshja kundër Francës ka hyrë tashmë në librat e historisë. Do ta kujtojmë gjithmonë atë lojë. Nëse do të kishim pak më shumë fat, ndoshta do të kishim eliminuar spanjollët [në çerekfinale, ku Zvicra humbi me penallti]. Fatkeqësisht, gjatë gjuajtjes së penalltive nuk patëm fat në anën tonë. Tregoi edhe një herë se jemi një ekip i mirë dhe se së bashku mund të arrijmë diçka. Ky është synimi ynë tani edhe për turneun në Gjermani dhe do të japim gjithçka për të bërë sërish histori. I pyetur se çfarë do të thotë të luash për Zvicrën, Xhaka është përgjigjur: "Të qenit në ekipin kombëtar dhe ta udhëheq atë si kapiten, është krenari për mua. Por



prapëseprapë, asnjëra prej këtyre gjërave [në vetete] nuk më bën dobi: Unë jam një person shumë ambicioz, dua të jem i suksesshëm. Dua ta drejtoj skuadrën për të bërë sërish histori në Gjermani, në mënyrë që ky ekip të mbahet mend dhe ne do të punojmë shumë për ta arritur këtë! Shumë lojtarë [tanë] kanë fituar tituj [këtë sezon]. Por shumë lojtarë kanë arritur gjithashtu në Ligën e Kampionëve, dhe kjo u jep atyre motivim dhe vetëbesim, dhe ne e ndiejmë këtë edhe gjatë stërvitjeve. Trajnimi është në një nivel shumë të lartë; për mendimin tim, nuk ka qenë kaq e lartë për një kohë të gjatë dhe ne shtyjmë njëri-tjetrin. Të gjithë duan të luajnë. Kemi shumë konkurrencë për vende. Dhe kjo e bën një ekip më të fortë dhe lojtarët individualë më të fortë. Kështu duhet të jetë". Në objektivin e Zvicrës për "Euro 2024",

Xhaka ka thënë se synim është kalimi i fazës së grupeve. "Natyrishë ne duam të kalojmë fazën e grupeve. Për mendimin tim, grupi që kemi është i vështirë. Por qëllimi ynë numër një është të arrijmë në 1/8 e finales, dhe më pas do të luajmë një ndeshje në një kohë dhe shpresojmë që të arrijmë sa më shumë që të jetë e mundur. Ndeshja e parë kundër Hungarisë është sigurisht e rëndësishme. Nuk po them se duhet të fitojmë, por padyshim që do të ishte shumë mirë nëse do ta nisnim turneun me fitore. Duhet të luajmë një lojë perfekte kundër Hungarisë dhe të qëndrojmë të fokusuar për 90 minuta. Dhe ne kemi nevojë për frymë ekipore. Së bashku jemi të fortë. Shpresojmë se do të jemi në gjendje ta tregojmë këtë në ndeshjen tonë të parë të shtunën", ka deklaruar Xhaka.

Shefi i Mercedesit: Në garën tjetër mund të korrin fitoren e parë

Shtuttgart, 15 qershor - Në këtë fillim zhgënjyes të kampionatit të Formula 1, Mercedesi nuk kishte arritur ende në podium. Magjia u prish në garën e nëntë të sezonit, atë të Kanadasë, në të cilën George Russell zuri "pole position" dhe përfundoi i treti, pak përpara shokut të skuadrës Lewis Hamilton. "Kur George vuri gomën e fortë, ne ishim të shpejtë dhe ai tregoi ritëm të shkëlqyeshëm. Për një moment menduam për fitoren, por nuk duhet të jemi shumë të pangopur", shpjegoi Toto Wolff, që gjatë garës i kërkoi britanikut të fokusohet të pista. "Nga njëra anë Russell ishte



shumë brilant, nga ana tjetër ndoshta mund të kishte shmangur disa gabime. Gjithsesi, ajo që ka rëndësi është t'u jepet shoferëve një makinë të shpejtë", ka shtuar Wolff, që ka një farë keqardhje pasi Mercedesi edhe mund ta kishte

fituar këtë garë. "Aspekti pozitiv është se kemi bërë një hap të vërtetë përpara, po sjellim pjesë të reja dhe drejtimi i zhvillimit është pozitiv. Kronometri do të jetë gjyqtari, por në tre garat e fundit kemi sjellë shumë pjesë të reja, të dukshme dhe më pak të dukshme, të cilat kanë kontribuar në rritjen e performances", ka deklaruar Wolff. Shefi i Mercedesit shprehet se s'do të ndalet këtu: "Në fabrikë bëmë një përpjekje të madhe, që nga Imola e këndej hodhëm hapat e duhur. Kemi gjëra të reja që vijnë, më shumë përditësime për Barcelonën, të cilat duhet të na ndihmojnë".

SHKURT

Qëndrim Ismajli nënshkruan me Tiranën

Klubi shqiptar, Tirana ka konfirmuar zyrtarisht transferimin e mbrojtësit të majtë, Qëndrim Ismajli, i cili së fundmi luajti te Gjilani. Pas një super-sezoni me Gjilanin në Superligën e Kosovës, Ismajli do të vazhdojë karrierën në Superiorene Shqiptare. Është vet klubi Tirana, i cili ka njoftuar zyrtarisht transferimin e 25-vjeçar me anë të një njoftimi në faqen zyrtare. Tirana nuk ka dhënë detaje tjera mbi kohëzgjatjen e kontratës së Ismajlit. "Klubi i Futbollit Tirana njofton se mbrojtësi i majtë Qëndrim Ismajli është zyrtarisht futbollisti më i ri i skuadrës. Mbrojtësi 25-vjeçar afrohet te Tirana nga kampionati i Kosovës, ku sezonin e fundit ka spikatur me Gjilanin, duke qenë ndër më të dalluarit në kampionat. Klubi i Tiranës i uron mirëseardhje Ismajlit dhe suksese në aventurën e tij të parë në kampionatin shqiptar", thuhet në njoftimin e Tiranës.

Tri klube italiane në garë për Mitajn

Në fillim Juventusit, ndërsa së fundmi në skenë kanë dalë edhe ekipi si Lazios dhe Bologna. Bëhet fjalë për Mario Mitaj, anësinorin kuqezin i cili pritet të jetë një nga të vëzhguarit special në sfidën Itali-Shqipëri dhe jo vetëm. Për talentin shqiptar ka shumë interes jo vetëm në Itali, fakt që e pranon edhe agjenti i tij. "Mitaj është një lojtar i rëndësishëm, një anësinor i majtë i vitit 2003. Ka goxha interesim për të, në Itali dhe jo vetëm. A do të vijë në Itali? Unë them po", u shpreh agjenti i tij Silvio Pagliari.

Morata: Në Evropian për të shkruar historinë, Shqipëria ka një ekip me cilësi

Sulmuesi spanjoll Alvaro Morata karikon kombëtaren e tij para ndeshjes së parë në "Euro 2024", duke folur në një intervistë për "Gazzetta dello Sport". "Me vijnë në këtë kompeticion me dëshirë dhe besim. "Kemi shansin të bëjmë histori sepse Spanja ka 3 kampionate evropiane si Gjermania dhe askush nuk ka fituar katër. Kështu që, këtu ne jemi të emocionuar dhe me një dëshirë të madhe për të punuar", ka thënë Morata. Spanja është rivale e Shqipërisë, në këtë turne: "Ne nuk jemi favoritë sepse ka shumë kombëtare spektakolare. Në Evropianin e fundit u eliminuam me penallti nga Italia, por ne i njohim ata dhe kemi fituar Ligën e Kombeve. Ne e dimë se si luajnë ata, ne e dimë gjenin e tyre konkurrues. Në grupin tonë një ekip që ka cilësi është edhe Shqipëria. Ne duhet të kujdesemi për topin, ta administrojmë atë ashtu si na pëlqen", ka shtuar Morata.

Hummelsi do të largohet nga Dortmundi

Mats Hummels pritet të largohet nga Borussia Dortmund. Kështu raporton eksperti i transferimeve, Fabrizio Romano, që thotë se edhe Dortmundi është pajtuar. Problemi i fundit i tij me trajnerin Edin Terziq thuhet se është njëri prej faktorëve që ka çuar deri te ky largim. Qendërmbrojtësi gjerman ishte shtylla e vijës së fundit të Dortmundit në kampanjën e tyre deri në finale të Ligës së Kampionëve. Hummelsi do të largohet si lojtar i lirë dhe mendon të vazhdojë në Evropë, duke e përjashtuar Arabinë Saudite.

Schweinsteiger: Ronaldo e fiton 'Këpucën e Artë' në 'Euro 2024'

Ish-mesfushori i Gjermanisë, Bastian Schweinsteiger, beson se kapiteni i Portugalisë, Cristiano Ronaldo, do të fitojë "Këpucën e Artë" në "Euro 2024". 39-vjeçari portugez vjen në

Kampionatin Evropian me një formë shumë të mirë. Pas një sezoni me 44 gola me klubin e tij Al Nassr, pesë herë fituesi i Topit të Artë shkëlqeu me dy gola në fitoren 3-0 të Portugalisë ndaj Republikës

së Irlandës në Aveiro në fillim të kësaj jave. Në mesin e një morie rekordesh që Ronaldo mund të vendosë në prag të "Euro 2024", është edhe fituesi i "Këpucës së Artë" për herë të dytë. 39-vjeçari

fitoi çmimin në edicionin e mëparshëm në vitin 2021, ku kampionia në fuqi Portugalia u eliminua në raundin e 1/8-ave. Schweinsteiger mendon se kapiteni i Portugalisë do të përsërisë

suksesin e 2021 shpesh në "Euro 2024" dhe do të krijojë më shumë histori. Në një postim në "Twitter", Schweinsteiger, kur u pyet se kush e fiton "Këpucën e Artë", ai u përgjigj: "Cristiano 'Euro 2024'".

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Meli Design” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811350884 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Meli Design” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811350884 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Meli Design” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811350884 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Molla M&L” Sh.P.K. me seli në Glllogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 8811396961 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Molla M&L” D.O.O. od Glllogovca, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 8811396961 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Molla M&L” L.L.C. with headquarters Glllogoc, has come to the decision to quit its business: 8811396961 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ambulanca Neuropsikiatrike “Mens Sana” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70933225.

- Miran Xhelili, shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës, me nr. KO-46627/A-05-20 Diploma: 0148/9 datë, 24.06.2013 Gjilan.

- Altin Kamberi nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Florije Rama Molliq KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Bajram Sadriu” Berjah nga kl. 1-8.

- Qëndresa Gjokaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Tahir Asllani Brovin KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Mimoza Paloja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat kl. 10.11.12.13. të sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

